



PËRMBLEDHJA E RAPORTIT

TITULLI I PROJEKTIT	TERMOCENTRALI ME GAZ NË KORÇË (GPP KORÇA)
TITULLI I DOKUMENTIT	PËRMBLEDHJE JO TEKNIKE E RAPORTIT TË THELLUAR TË VNM-SË

RISH.	QËLLIMI I PUBLIKIMIT	PËRSHKRIMI	EMRI	DATA
1	Përmbledhje jo teknike e raportit të thelluar të VNM-së		Abkons	24/09/2018

QËLLIMI PËRFUNDIMTAR PËR PUBLIKIM

	KONSULENTI			KONTRAKTORI	
	Punoi	Kontrolloi	Miratoi	Kontrolloi	Miratoi
Emri/ Mbiemri	Abkons	H. Kamberi	R. Basha	K. Condic	A. Salopek
Firma					
Data	24/09/2018	24/09/2018	24/09/2018		
Statusi i Dokumentit					



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Përmbajtja

AKRONIMET DHE SHKURTIMET	5
HYRJE	7
PËRSHKRIM I SHKURTËR I PROJEKTIT TË PROPOZUAR	8
KUADRI LIGJOR DHE I POLITIKAVE MJEDISORE	14
INTERPRETIMI LIGJOR DHE KËRKESAT LIGJORE MBI PROJEKTIN E PROPOZUAR	14
RËNDËSIA E PROJEKTIT	14
1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT	16
1.1 Përshkrimi Teknik i TEC-it dhe Proceset e Impiantit	18
1.1.1 Balanca e termocentralit me gaz	21
1.1.2 Principet e TEC-it të Korçës (CCCPP).....	22
1.2 Fazat e projektit	28
1.2.1 Faza e Ndërtimit	28
1.2.2 Faza e Funkionimit.....	28
1.2.3 Faza e Dekomisionimit	31
2 NJË PËRSHKRIM I ANALIZIMIT TË ALTERNATIVAVE TË MUNDSHME PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT	32
2.1 Pa Projekt.....	32
2.2 Vend dhe plan tjetër alternativ për projektin.....	32
2.3 Teknologjitë alternative të prodhimit të energjisë.....	33
3 PËRSHKRIM I GJENDJES DHE VLERAVE EKZISTUESE TË MJEDISIT, QË MUND TË NDIKOHEN NGA ZBATIMI I PROJEKTIT TË PROPOZUAR	34
3.1 Përshkrimin e karakteristikave fizike të zonës së projektit.....	34
3.1.1 Përshkrim të faktorëve klimatikë	34
3.1.2 Përshkrim geomorfologjik dhe të sizmicitetit të zonës së projektit	36
3.1.3 Përshkrim të gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit	36
3.1.4 Përshkrim të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.....	37
3.2 Përshkrimin e biodiversitetit në zonën e projektit	40
3.2.1 Përshkrim të habitateve kryesore në zonën e projektit.....	40
3.2.2 Përshkrim të vegjetacionit në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre	41
3.2.3 Përshkrimin e zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti, përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj	44
3.3 Përshkrimin e cilësisë së mjedisit.....	45
3.4 Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti.....	46

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

3.4.1	Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti.....	46
3.4.2	Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës.....	46
3.4.3	Përdorimi i tokës në zonën e projektit	47
3.4.4	Administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura urbane.....	47
4	NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS.....	48
4.1	Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit.....	48
4.2	Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit	50
4.3	Ndikimet vizuale dhe ruajtja e peisazhit	50
4.4	Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve.....	51
4.5	Ndikimet sociale të projektit	52
5	KARAKTERISTIKAT E NDIKIMEVE NEGATIVE NË MJEDIS	54
5.1	Metodat e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis	54
5.1.1	Vlerësimi i Ndikimeve dhe Metodologjia.....	54
5.2	Shtrirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuara (shkalla).....	54
5.2.1	Shtrirja e mundshme hapësinore e ndikimeve negative në mjedis.....	54
5.2.2	Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve negative të identifikuara.....	56
6	NDIKIMET NË MJEDISIN NDËRKUFITAR TË PROJEKTIT(NËSE KA TË TILLA)	58
7	MASAT E PROPOZUARA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT NGA SECILI NDIKIM NEGATIV	59
7.1	Masat zbutëse për ndikimet në ujërat sipërfaqësorë.....	59
7.2	Masat zbutëse për ndikimet në ujërat nëntokësorë.....	59
7.3	Masat zbutëse për ndikimet në cilësinë e ajrit	59
7.4	Masat zbutëse për ndikimet në cilësinë e tokës.....	60
7.5	Masat zbutëse për kontrollin e zhurmave dhe vibrimeve	61
7.6	Masat zbutëse për ndikimet nga mbetjet dhe dherat natyralë të gjermuar.....	61
7.7	Masat zbutëse për ndikimet në florë.....	63
7.8	Masat zbutëse për ndikimet në faunë	63
7.9	Masat zbutëse për ndikimet vizuale dhe ruajtjen e peizazhit	63
7.10	Masat zbutëse për sigurinë në punë.....	64
7.11	Mekanizmi i Ankesave.....	64
	KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.

Tabelat

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Tabela 0-1 Koordinatat gjeografike të Projektit	10
Tabela 3-1 Temperatura mesatare mujore dhe mesatare vjetore e ajrit (°C) (1951 – 1990)	34
Tabela 3-2 Temperatura minimale absolute e ajrit (°C) (1951 – 1990)	34
Tabela 3-3 Temperatura maksimale absolute e ajrit (°C) (1951 – 1990)	34
Tabela 3-4 Sasia mujore dhe sezonale e rreshjeve (mm) (1951 - 1990)	35
Tabela 3-5 Numri i ditëve me rreshje (1951 - 1990)	35
Tabela 3-6 Numri i ditëve me borë sipas muajve dhe totali vjetor (1951 - 1990)	35
Tabela 3-7 Drejtimet e erave të matura në stacionin e Sheqeras, Korçë	35
Tabela 3-8 Statusi ekologjik i specieve të florës	42
Tabela 4-1. Standardet e nivelit të zhurmave në mjedis	50
Tabela 4-2: Emetimet në ajër të TEC-it të Korçës	51
Tabela 4-3: Emetimet në ajër të impiantit të ujit të nxeht (80 MW), me karburant gazin natyror	51
Tabela 4-4: Emetimet në ajër për impiantin e ujit të nxehtë (80 MW), me karburant nafte extra të lehtë	52
Tabela 5.1 Zonat e Influencës për secilin prej aspekteve mjedisore dhe sociale	54
Tabela 5.2. Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve negative të identifikuara	56

Figurat

Figura 0.1 Harta topografike e projektit të propozuar për TEC Korçë	9
Figura 1.1 Projektimi konceptual paraprak i TEC Korçë	17
Figura 1.2 Planimetria e skemës së TEC Korçë.....	20
Figura 1.3 Planimetri e zonës ku do ndërtohet TEC Korçë	22
Figura 1.5 Pamje ilustruese e një sistemi CCCPP dhe principet e tij	23
Figura 1.6 Përzierja e gazit natyror dhe ajrit në turbinën e gazit gjatë diegies së njëpasnjëshme	24
Figura 1.7 Turbina e gazit me diegie jo të njëpasnjëshme	24
Figura 1.8 Kondesatori i ftohësit të ujit	25
Figura 1.9 Pamje e gjeneratorit të avullit për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG)	26
Figura 1.10 Planimetria e një gjeneratori të zakonshëm për turbinën e gazit dhe turbinën e avullit	27
Figura 1.11 Pamje 3-D e TEC Korçës	27
Figura 3.1 Trëndafilat e erave në Sheqeras, Korçë.....	36
Figura 5.1 Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis.....	54

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Akronimet dhe Shkurtime

AC	Ajër i Kondicionuar
AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
BE	Bashkimi European
CCCPP	Termocentral me Cikël të Kombinuar Kogjenerimi
DC	Ftohje Qëndrore
DE-MI	Demineralizim
DRM	Drejtoria Rajonale e Mjedisit
EPA	Agjencia e Mbrojtjes së Mjedisit
GN	Gaz Natyror
GPP	Termocentral me Gaz
ha	hektarë
HRSG	Gjeneratori i avullit për rikuperimin e nxehtësisë
HVAC	Ngrohje, Ventilim dhe Ajër i Kondicionuar
IFC	Korporata Ndërkombëtare e Financimit
IHMSH	Instituti i Hidrometeorologjisë së Shqipërisë
ITUN	Impianti i Trajtimit të Ujrave të Ndotura
kV	kilowatt
m	metër
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MW	megwatt
MWe	megawatt elektrike
MWt	megawatt termike
NS	Nën-Station
PM	Grimcat e Ngurta Pezull
PMMS	Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

QKL	Qendra Kombëtare e Licensimit, tashme e njohur me emërtimin Qendra Kombëtare e Biznesit
TAP	Trans Adriatic Pipeline
TEC	Termocentral
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
VNMS	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Social
VOCs	Komponimet organike të paqëndrueshme
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Hyrje

GPP Korça sh.p.k, e regjistruar në Shqipëri si një degë e kompanisë IVICOM me NUIS/NIPT L73724004N, propozon ndërtimin dhe operimin e një termocentrali me gaz me cikël të kombinuar kogjenerimi CCCPP KORCA 500 MW / 80 MW / 5 MW në zonën pranë qytetit të Korçës në Shqipëri. Termocentrali do të prodhojë deri në 500 MWe energji duke përfshirë nxjerrjen e avullit deri në 80 MW për ngrohjen qendrore dhe rreth 5 MW për ujë të ngrohtë sanitar. Projekti TEC Korça përbëhet nga një tubacion gazi 2.1 km që do të lidhë termocentralin me Projektin TAP dhe një linjë elektrike transmetimi të dyfishtë 400 kV rreth 11.15 km për lidhjen me rrjetin në Nën-Stationin Zëmbllak.

Projekti ka marrë statusin e Investimit Strategjik nga Qeveria Shqiptare, duke e konsideruar projektin e propozuar një zhvillim të rëndësishëm për vendin. Në kuadër të projektit po zhvillohet procesi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), i cili do të duhet të përmbushë kërkesat e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC) dhe në përputhje me legjislacionin kombëtar Shqiptar dhe legjislacionin e BE-së për përgatitjen e vlerësimeve mjedisore dhe sociale të nevojshme për marrjen e lejes mjedisore, si dhe për qëllime të tjera autorizimi. Në vijim të procesit dhe në zbatim të kërkesave ligjore është përgatitur Raporti i Thelluar i VNM-së ku jepet një informacion i detajuar mbi projektin, kushtet ekzistuese të mjedisit dhe aspekteve socio-ekonomike, aktivitetet ndërtimore që do të kryhen, ndikimet në mjedis nga zbatimi i projektit, masat që duhet të merren për minimizimin e këtyre ndikimeve, si dhe plani i menaxhimit mjedisor dhe social (PMMS).

Në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar nevojitet përgatita e këtij raporti si përmbledhje jo teknike e raportit të thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM-së), e cila do të shërbejë fillimisht gjatë fazës së dëgjësës publike, dhe më pas si shtojcë e raportit të thelluar të VNM-së.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Përshkrim i shkurtër i projektit të propozuar

IVICOM Consulting Ltd synon të ndërtojë një termocentral të ri me vendodhje në pjesën veri-lindore të qytetit të Korçës. Termocentrali do të përbëhet nga turbinat me gaz me kapacitet të përgjithshëm të instaluar prej 500 MW, i cili do të prodhojë gjithashtu ngrohje me avull 80 MW dhe 5 MW për ujë të ngrohtë sanitar.

Projekti do të përfshijë një tubacion (rreth 2.1 km) për të marrë gaz nga rrjeti i tubacionit të Projektit Trans Adriatic Pipeline (TAP) dhe një linjë të re transmetimi elektrike, të dyfishtë 400 kW, (rreth 11.15 km) nga vendi i projektit në nënstacionin ekzistues elektrik në Zëmlak .

Termocentrali i ri ndodhet në pjesën veri-lindore të qytetit të Korçës pranë impiantit ekzistues të trajtimit të ujërave të ndotura në Korçë. Zona e propozuar për zhvillim është e vendosur dhe e rrethuar nga tokë bujqësore. Projekti i propozuar do të përdorë një sipërfaqe prej 909.190 m² me shtrirje në rajonin e Korçës, Pojan, Kuç i Zi, Belorta, Dishnicë, Barç, Zëmlak, Malavec, Neveçisht, për ndërtimin e termocentralit të gazit, lidhjen me TAP dhe ndërtimin e linjës elektrike të transmetimit në NS Zëmlak. Duke iu referuar sipërfaqes së përgjithshme prej 909,190 m², sipërfaqja e tokës së përhershme që do të merret për ndërtimin e termocentralit të gazit është 245,208 m². Në lidhje me zonën e propozuar, vlen të theksohet se aktualisht kjo zonë është e aksesueshme nëpërmjet rrugëve ekzistuese rurale, të cilat përdoren edhe për aksesin dhe shfrytëzimin e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane në Korçë. Pjesë e projekti janë edhe rehabilitimi/rindërtimi i dy seksioneve të shkurtra të rrugëve ekzistuese, të cilat do të përdoren si rrugë hyrëse/aksesi. Segmenti i parë rrugor është 2,550 m dhe segmenti i dytë rrugor është 160 m (rrugë aksesi për termocentralin).

Më poshtë paraqitet harta topografike e projektit të propozuar.





  	
<i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)


Figura 0.1 Harta topografike e projektit të propozuar për TEC Korçë



		
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

Tabela 0-1 Koordinatat gjeografike të Projektit

Objektet e Projektit	Numri i pikës	WGS84 UTM 34N		Pulkovo42 GaussKruger 4N	
		X	Y	X	Y
Linja Ajrore e Transmetimit	P1	490028.872	4505595.537	490156.288	4507529.116
	P2	489633.886	4505598.837	489761.140	4507532.417
	P3	489233.899	4505602.178	489360.991	4507535.760
	P4	488849.845	4505605.387	488976.780	4507538.971
	P5	488397.352	4505557.687	488524.102	4507491.252
	P6	487870.273	4505502.125	487996.807	4507435.667
	P7	487409.097	4505453.510	487535.443	4507387.032
	P8	487053.092	4505221.378	487179.293	4507154.806
	P9	486659.392	4504964.668	486785.432	4506897.991
	P10	486257.315	4504702.495	486383.191	4506635.711
	P11	485855.239	4504440.322	485980.950	4506373.432
	P12	485461.539	4504183.612	485587.089	4506116.617
	P13	485092.969	4503943.287	485218.369	4505876.194
	P14	484732.775	4503708.424	484858.028	4505641.235
	P15	484385.147	4503481.754	484510.257	4505414.473
	P16	484060.377	4503269.989	484185.355	4505202.622
	P17	483756.918	4502994.285	483881.771	4504926.806
	P18	483427.553	4502695.046	483552.272	4504627.444
	P19	483094.489	4502392.444	483219.072	4504324.719
	P20	482768.825	4502096.566	482893.274	4504028.721
	P21	482467.222	4501822.549	482591.548	4503754.592
	P22	482403.836	4501427.604	482528.136	4503359.486
	P23	482329.358	4500963.542	482453.627	4502895.234
	P24	482253.295	4500489.607	482377.533	4502421.106
	P25	482175.647	4500005.799	482299.853	4501937.100

				 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>	
Kompania	Abkons sh.p.k				
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)				

	P26	482107.604	4499581.836	482231.782	4501512.964
Kufiri i Tokës së blerë GPP	G1	481905.883	4498961.127	482029.978	4500892.001
	G2	481992.341	4499033.533	482116.471	4500964.437
	G3	482077.073	4499103.541	482201.238	4501034.474
	G4	482208.230	4499212.034	482332.449	4501143.011
	G5	482218.638	4499200.534	482342.861	4501131.506
	G6	482273.158	4499388.956	482397.403	4501320.006
	G7	482277.695	4499399.591	482401.942	4501330.644
	G8	482291.788	4499444.571	482416.041	4501375.643
	G9	482125.538	4499510.696	482249.724	4501441.795
	G10	482117.597	4499512.663	482241.779	4501443.763
	G11	482125.694	4499545.356	482249.879	4501476.469
	G12	482109.522	4499549.349	482233.701	4501480.464
	G13	481992.716	4499580.439	482116.847	4501511.566
	G14	481991.876	4499576.878	482116.007	4501508.004
	G15	481985.125	4499578.470	482109.253	4501509.597
	G16	481853.058	4499630.262	481977.132	4501561.410
	G17	481821.922	4499467.506	481945.983	4501398.587
	G18	481811.291	4499405.032	481935.348	4501336.088
	G19	481779.892	4499231.984	481903.936	4501162.969
	G20	481771.714	4499185.199	481895.754	4501116.166
	G21	481767.353	4499160.253	481891.392	4501091.210
	G22	481770.468	4499134.235	481894.508	4501065.180
	G23	481779.144	4499117.334	481903.188	4501048.273
	G24	481784.101	4499104.942	481908.147	4501035.876
	G25	481823.587	4499058.998	481947.649	4500989.913
Rrugë Aksesi	R1	482036.358	4498792.098	482160.506	4500722.903
	R2	482036.358	4498792.097	482160.506	4500722.903
	R3	482025.188	4498787.956	482149.331	4500718.760






LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

R4	482016.133	4498784.608	482140.273	4500715.411
R5	482005.783	4498780.533	482129.918	4500711.334
R6	482003.591	4498779.677	482127.726	4500710.478
R7	482002.463	4498782.732	482126.597	4500713.534
R8	482009.057	4498796.795	482133.194	4500727.603
R9	481992.548	4498823.238	482116.678	4500754.057
R10	481976.547	4498845.265	482100.671	4500776.093
R11	481751.688	4499113.113	481875.721	4501044.050
R12	481737.567	4499168.253	481861.593	4501099.212
R13	481744.503	4499201.066	481868.533	4501132.039
R14	481745.823	4499210.812	481869.853	4501141.789
R15	481891.407	4499935.872	482015.496	4501867.145
R16	481893.648	4499956.298	482017.738	4501887.580
R17	481892.487	4499970.910	482016.578	4501902.197
R18	481890.115	4499978.980	482014.204	4501910.270
R19	481576.380	4501183.794	481700.342	4503115.576
R20	481585.934	4501186.273	481709.900	4503118.057
R21	481901.784	4499976.608	482025.878	4501907.898
R22	481902.908	4499938.166	482027.002	4501869.440
R23	481804.840	4499447.771	481928.894	4501378.845
R24	481793.386	4499386.578	481917.435	4501317.627
R25	481758.232	4499212.492	481882.267	4501143.469
R26	481754.230	4499192.673	481878.263	4501123.642
R27	481748.844	4499166.003	481872.876	4501096.961
R28	481760.496	4499120.507	481884.532	4501051.447
R29	481857.092	4499006.094	481981.167	4500936.988
R30	481894.336	4498961.079	482018.427	4500891.954
R31	481985.355	4498852.659	482109.482	4500783.490
R32	482002.303	4498829.328	482126.437	4500760.149

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

	R33	482020.810	4498799.684	482144.952	4500730.493
	R34	482035.445	4498794.680	482159.593	4500725.486
	R35	482036.351	4498792.117	482160.499	4500722.923
	R36	481772.463	4499189.486	481896.504	4501120.454
	R37	481776.369	4499208.829	481900.412	4501139.805
	R38	481806.482	4499376.981	481930.537	4501308.026
	R39	481817.281	4499440.233	481941.340	4501371.303
	R40	481864.533	4499010.294	481988.612	4500941.189
Stacioni i Matjes së Gazit	GM1	481607.168	4501056.595	481731.143	4502988.325
	GM2	481538.476	4501009.575	481662.422	4502941.287
	GM3	481487.947	4501192.105	481611.873	4503123.891
	GM4	481562.286	4501242.024	481686.242	4503173.830
Impianti i Trajtimit të Ujrave të zeza	WP1	481671.069	4499229.619	481795.068	4501160.604
	WP2	481669.087	4499219.543	481793.086	4501150.523
	WP3	481745.823	4499210.812	481869.853	4501141.789
	WP4	481744.503	4499201.066	481868.533	4501132.039
Rinkonstrucioni i Nënstacionit Zemblak	SS1	490132.489	4505607.348	490259.948	4507540.931
	SS2	490076.726	4505683.285	490204.162	4507616.900
	SS3	490178.717	4505756.825	490306.194	4507690.469
	SS4	490209.792	4505714.478	490337.282	4507648.105
	SS5	490122.546	4505649.471	490250.001	4507583.072
	SS6	490146.179	4505617.471	490273.643	4507551.059
Aksi i Gazsjellësit	PA1	481743.206	4499167.128	481867.234	4501098.087
	PA2	481897.269	4499939.292	482021.361	4501870.566
	PA3	481898.781	4499957.283	482022.874	4501888.565
	PA4	481896.220	4499975.155	482020.312	4501906.444
	PA5	481580.876	4501182.885	481704.840	4503114.667

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Kuadri ligjor dhe i politikave Mjedisore

Interpretimi ligjor dhe kërkesat ligjore mbi projektin e propozuar

Sipas ligjit Nr.10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar, projekti i propozuar nga GPP Korça “Termocentrali me Gaz në Korçë” klasifikohet si në përcaktimin e bërë:

Shtojcës I - Projekte që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, Pika 2: Termocentrale ose instalime të tjera me djegie, me një prodhim nxehtësie prej 20 ose më shumë megavatësh.

Në vijim, sipas Ligjit Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për Lejet e Mjedisit” i ndryshuar, projekti i propozuar GPP Korça klasifikohet si projekt që i përket **Industirisë Energjitike, ID: 1.1 Instalimet me djegie, Kapaciteti kufi për Lejet e Tipit A: Energjia termike në hyrje është e barabartë ose më e madhe se 50 MW.**

Rëndësia e Projektit

Sektori shqiptar i energjisë është identifikuar si një nga sektorët e rritjes strategjike, shpesh referuar si mundësues për rimëkëmbjen ekonomike të vendit. Ka ende përpjekje të konsiderueshme për t'u bërë në sektorin e gazit, ku fokusi kryesor është gazifikimi i vendit.

Shqipëria aktualisht disponon vetëm rezerva të kufizuara të gazit natyror dhe ende nuk ka një qasje në tregjet ndërkombëtare të gazit natyror. Në varësi të rezultateve të eksplorimit në 5-10 vitet e ardhshme, si dhe me zhvillimin e Projektit TAP, Shqipëria do të shqyrtojë mundësinë e shfrytëzimit dhe transportimit të gazit natyror më gjerësisht. Shqipëria duhet të marrë parasysh shpërndarjen e gazit natyror në të gjithë vendin, por kjo nuk mund të pritet përpara vitit 2020, edhe në kushtet më të favorshme. Lidhja e planifikuar me TAP (jo më herët se 2020) dhe gjetja dhe shfrytëzimi i mundshëm i gazit vendor do të përcaktojë specifikat e tregut të gazit natyror më vonë.

Kuadri i përgjithshëm i politikës së energjisë për zhvillimin e sektorit të energjisë është pjesë e Strategjisë Kombëtare të Përgjithshme për Zhvillimin Ekonomik të Shqipërisë. Ky dokument analizon dhe përfshin masat e nevojshme dhe hapat që duhet të ndërmerren në mënyrë që të rritet siguria e furnizimit me energji dhe optimizimi i burimeve energjetike për të përmbushur kërkesat dhe për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në të ardhmen.

Strategjia përmban një numër objektivash specifike, duke përfshirë:

- Forcimi i besueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së furnizimit me energji duke shfrytëzuar në mënyrë të duhur burimet ekzistuese të energjisë, ndërtimin e centraleve të reja gjeneruese, diversifikimin e furnizimit me energji si dhe lidhjen e vendit me rrjetet rajonale të tubacioneve të energjisë elektrike, naftës dhe gazit;
- Përdorimi efikas dhe optimal i energjisë duke siguruar ndikimin më të ulët të mundshëm në mjedis, i cili mund të bëjë sektorin energjetik një sektor mbështetës për zhvillimin e qëndrueshëm të të gjithë sektorëve të tjerë ekonomikë dhe socialë;
- Krijimi i një kuadri rregullator dhe institucional efektiv në përputhje me standardet e BE-së dhe në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Shqipëria.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

"Strategjia Kombëtare e Energjisë, (e përditësuar)", vlerëson se konsumi i gazit deri në vitin 2030 do të jetë në nivelin 1.5 deri në 1.8 bcm në vit, me konsumatorët kryesorë që pritet të jenë:

- **Prioriteti i parë:** sektori i prodhimit të energjisë dhe konsumatorët industrialë,
- **Prioriteti i dytë:** sektorët e shërbimeve, të cilat do të përdorin gazin natyror për ngrohje,
- **Prioriteti i tretë:** sektori rezidencial për përdorimin e gazit natyror për ngrohje, gatim dhe prodhimin e ujit të ngrohtë.

Në përputhje me këto prioritete, TEC-i i propozuar i Korçës do të prodhojë rreth 500 MW energji duke përfshirë 80 MW për prodhimin e avullit për ngrohjen qendrore të qytetit të Korçës dhe për nevoja të tjera të bujqësisë, si dhe 5 MW për ujë të ngrohtë sanitar. Në këtë kuadër, projekti do të jetë në gjendje të ofrojë një teknologji të përparuar dhe pro- mjedisore, e cila optimizon shfrytëzimin e burimeve energjetike, për të plotësuar nevojat lokale dhe rajonale dhe të arrijë një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në të ardhmen. Ai përfaqëson një teknologji të efektshme që siguron përdorimin optimal të energjisë duke siguruar ndikimin më të ulët të mundshëm në mjedis, zhvillimin e qëndrueshëm të të gjithë sektorëve të tjerë ekonomikë dhe socialë dhe duke rritur cilësinë e jetesës së popullsisë lokale.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

1 Përshkrimi i projektit

Termocentrali i propozuar do të jetë një impiant me cikël të kombinuar kogjenerimi (CCCPP) i cili përbëhet nga komponentët dhe specifikimet e listuara më poshtë:


- 500 MW termocentral me gaz (CCCPT);
- 2.1 km tubacion në veri të zonës së propozuar për ndërtimin e TEC-it për të mundësuar furnizimin me gaz nga Projekti Trans Adriatic Pipeline (TAP);
- 11.2 km linjë dyfishe transmetimi 400 kV për lidhjen e TEC Korçë me nënstacioni ekzistues në Zëmlak;
- rehabilitimi i dy rrugëve të aksesit për qëllime shërbimi, rruga hyrëse 1 me gjatësi 2550 m dhe rruga hyrëse 2 me gjatësi 160 m.
- Uji hyrës për procesin e ftohjes së TEC-it do të merret nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura urbane në afërsi të zonës së propozuar dhe në rast emergjence do të përdoren dy puse brenda zonës së projektit;
- 80 MW për prodhimin e avullit të ngrohtë, i cili do të sigurojë ngrohjen qendrore të qytetit të Korçës në të ardhmen;
- 5 MW për prodhimin e ujit të ngrohtë sanitar.

Energjia e gjeneruar në impiant do të transmetohet nëpërmjet linjës së dyfishtë 400 kV në stacionin ekzistues të energjisë NS Zëmlak dhe do të prodhojë 500 MWe. Ndër avantazhet e tjera (p.sh, zvogëlimi i humbjeve të linjës, sigurimi i kapaciteteve shtesë dhe sigurimi i një burimi alternativ të energjisë për sektorin energjetik shqiptar), energjia e gjeneruar nga ky Projekt pritet të lehtësojë operacionet e rrjetit në drejtim të përmirësimit të përgjithshëm të tensionit dhe stabilitetit të sistemit.

Në hartën e mëposhtme paraqitet një Projektim Konceptual Paraprak i TEC Korçës.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 1.1 Projektimi konceptual paraprak i TEC Korçë



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

1.1 Përshkrimi Teknik i TEC-it dhe Proceset e Impiantit

TEC-i i i Korçës do të prodhojë energji elektrike në kapacitet prej 500 MW, si dhe prodhimin e avullit prej maksimum 80 MW për ngrohjen qendrore të qytetit të Korçës (DH). Gjithashtu do të kemi një prodhim të përhershëm prej rreth 6 MW për ujin e ngrohtë sanitar. Të dhënat për ujin e ngrohtë për projektimin për dimër DH: hyrje 60-70°C, dalje maksimumi 130°C, fuqi 80 MWt. Të dhënat për ujin e nxehtë për projektimin për verë DH: hyrje 50- 60°C, dalje maksimumi 70°C, fuqi 4 -8 MWt.

Impianti do të operojë me gaz natyror i cili do të furnizohet nëpërmjet linjës së lidhjes së tubacionit të gazit. Do të sigurohen edhe lehtësia për filtrimin, matjen, ngrohjen dhe zvogëlimin e presionit të furnizimit me lëndë djegëse. Sistemi me cikël të kombinuar me bosht të vetëm është zgjedhur si teknologji e përshtatshme për termocentralin. Ai përbëhet nga një turbinë gazi, një turbinë me avull, dhe një gjenerator me avull për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG), me turbinë gazi dhe turbinë me avull të lidhura në secilën anë të gjeneratorit turbo të vetëm për të formuar një linjë me bosht të vetëm. Avantazhi kryesor i teknologjisë me bosht të vetëm është lehtësia e tij në operim, e cila rrit besueshmërinë me 1% më shumë në krahasim me blloqet me shumë boshte. Fleksibiliteti operacional vjen nga fakti se turbina me avull mund të shkëputet, duke përdorur një shtrëngim vetë-sinkronizues gjatë fillimit ose për operimin e ciklit të thjeshtë të turbinës së gazit.

Projekti Konceptual Paraprak paraqet një përshkrim të shkurtër të komponentëve dhe sistemeve kryesore të termocentralit. Ky impiant energjie përfshin një modul me bosht të vetëm 1+1 të përbërë nga Turbina e Gazit N.1, turbina me avull për rikuperimin e energjisë N.1, turbina me avull N.1 e lidhur me kondensator sipërfaqësor; Turbina e Gazit dhe Turbina e Avullit lidhen në një gjenerator elektrik me ftohje hidrogjeni.

Sistemi i impiantit elektrik do të projektohet duke marrë në konsideratë pajisje të përshtatshme ndihmëse, burimin rezervë të energjisë dhe pajisjet e mbrojtjes për të siguruar vazhdimësinë maksimale të shërbimit dhe gjithashtu për të siguruar veprimtarinë e pajisjes themelore gjatë kushteve të emergjencave. Shpërndarja e energjisë elektrike në ndihmësit e impiantit do të konsistojë në katër nën-sisteme kryesore:

- Furnizimi me energji të AC;
- Furnizimi me energji DC vitale për furnizimin me energji të AC;
- Furnizimi në rast emergjencash.

Lidhje kryesore për operacionet e impiantit janë:

- Qarkullimi i ujit në hyrje dhe dalje të tubacionit drejt kondensatorit dhe sistemit të mbyllur të ujit ftohës;
- Gazi natyror i furnizuar nga tubacioni kombëtar i presionit të lartë;
- Lidhja me rrjetin elektrik HV (tension i lartë); uji për qëllime industriale i furnizuar nga burime vendore të jashtme;
- Ujë higjeno-sanitar (ujë i pijshëm), i furnizuar nga burime lokale të jashtme;
- Shkarkimi i ujërave të ndotura.


TEC-i do të llogaritet mbi bazën e të dhënave të mëposhtme për gazin në hyrje. Bojlerët e ujit të nxehtë do të llogariten mbi bazën e të dhënave të mëposhtme për gazin në hyrje dhe vetëm në emergjenca në hyrjet e mëposhtme të të dhënave për lëndën djegëse të lehtë ekstra. Godinat kryesore dhe sistemet brenda zonës së projektit janë:




			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Dhoma kryesore e kontrollit dhe Godina Elektrike;
- Godina e qëndrimit për zhvillimin e takimeve;
- Impianti i trajtimit të ujit;
- Kompresor / godina e pompës zjarrfikëse;
- Impianti i pastrimit me lëndë të kondensuar;
- Pompat e furnizimit me ujë;
- Godina e pompës së ujit dhe ajo elektrike;
- Konteinerë mbajtës H2;
- Kabina;
- Zona e pikës së furnizimit me lëndë djegëse;
- Sistemi monitorimit të emetimeve;
- Seti DG i Emergjencës;
- Sistemi i kampionimit;
- Godina e administratës dhe kontrollit.

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 1.2 Planimetria e skemës së TEC Korçë



			 <i>LOCAL Knoëledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		


1.1.1 Balanca e termocentralit me gaz

Në vazhdim, termocentrali me gaz në Korçë do të përbëhet nga komponentët dhe pajisjet e tjera ndihmëse si:

- Sistem bypass për avullin;
- Sistemi kryesor për avullin dhe sistemi ndihmës për avullin;
- Sistemi për ujin hyrës (të nevojshëm për procesin teknologjik);
- Sistem vakumi;
- Sistem dranazhimi;
- Sistem uji për ftohje me cikël të mbyllur;
- Sistem ngrohje, ventilim dhe ajër kondicionimi (HVAC);
- Vinça dhe sisteme ngritëse;
- Sistem për ruajtjen e gazeve dhe shpërndarjen e tyre;
- Sistem marrje mostrash;
- Laborator kimik;
- Impiant demineralizimi dhe filtrimi për ujin e kondesuar;
- Impiant për ujin hyrës;
- Stacion për reduktimin e presionit të gazit, filtrimin, matjen dhe ngrohjen;
- Kulla ftohëse hibride me pompa uji për ftohje;
- Impiant për trajtimin e ujit të ndotur;
- Sistem për hedhjen e kimikateve;
- Stacion për ajrin e kompresuar;
- Godina e komandimit të termocentralit;
- Sistem uji kundër zjarrit;
- Sistem dedektimi dhe alarmi;
- Zjarrfikëse.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 1.3 Planimetri e zonës ku do ndërtohet TEC Korçë



1.1.2 Principet e TEC-it të Korçës (CCCPP)


Kogjenerimi është një teknikë ku prodhimi i nxehtësisë dhe energjisë elektrike ndodh në një proces të vetëm ose në termocentral. Një termocentral modern që prodhin energji nga lëndët fosile (në rastin në fjalë lënda djegëse është gaz) transformon rreth 60% të përmbajtjes së energjisë primare të lëndës djegëse në energji elektrike dhe çliron pjesën tjetër si prodhim të nxehtësisë. Kogjenerimi ose kombinimi i nxehtësisë dhe energjisë (CHP), përdor një pjesë të kësaj nxehtësie për të plotësuar një kërkesë për ngrohje, e cila përndryshe do të kërkonte energji nga një burim tjetër, zakonisht një lëndë djegëse tjetër. Ngrohja është shpesh në formën e gazeve të nxehtë të shkarkimit, avullit dhe/apo ujit të nxehtë. CHP kështu përmirëson efikasitetin e përgjithshëm të përdorimit të lëndës djegëse dhe kursen në energji primare në krahasim me prodhimin konvencional të veçantë (të ndarë) të energjisë dhe ngrohjes, por më shumë, kur përmbajtja e karbonit të nxehtësisë së harxhuar shqyrtohet nga pikëpamja e parimeve termodinamike, rezulton të jetë në mënyrë të konsiderueshme më pak se sa mënyrat e tjera të sigurimit të nxehtësisë.

Në Sistemet me Cikël të Kombinuar Kogjenerimi (CCCPP) energjia e lëndës djegëse konvertohet pas krijimit të punës mekanike në energji elektrike dhe fuqi termike të avullit. Termocentralet më cikël të thjeshtë ose të ndarë përbëhen nga një turbinë me gaz që është e lidhur me gjeneratorin elektrik dhe prodhon energji elektrike. Cikli i thjeshtë ka një efikasitet të ulët dhe në rastin tonë për TEC Korçën përmirësohet me anë të ciklit të kombinuar CCCPP në të cilin:

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

- Gjeneratori i avullit për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG) kap ngrohjen e shkarkimit nga turbina me gaz (që përndryshe do të shpëtonte përmes kullës së shkarkimit) dhe krijon avull duke e dërguar atë në turbinën e avullit.
- Turbina me avull i dërgon energji shtesë boshtit të gjeneratorit ku konvertohet në energji shtesë dhe në procesin e kogenerimit, të parashikuar për Korçën, pasi janë kryer punët mekanike të një pjese të avullit, ai nxirret/ekstraktohet dhe përdoret si burim nxehtësie për ngrohjen e ujit për ngrohjen qendrore.

Figura 1.4 Pamje ilustruese e një sistemi CCCPP dhe principet e tij




Pjesët kryesore të termocentralit të propozuar (CCPP) janë:

- 1) **Turbina e gazit** - Përzierjet e gazit natyror dhe ajrit digjen në dhomën e djegies së turbinës së gazit (GT). Për shkak të djegies së njëpasnjëshme turbina e gazit GT ka veti të shkëlqyera kur punon me ngarkesë të pjesshme. Ngarkesa minimale e impiantit me cikël të kombinuar të energjisë elektrike në përputhje me kufijtë e lejuara të emetimeve, mund të arrijë 40% ose edhe më poshtë. TEC-i mund të operohet nën ngarkesën e impiantit me 20% pa djegësin e njëpasnjëshëm SEV (Sequential Environmental Combustor) në punë gjatë fazës së funksionimit.


			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Figura 1.5 Përzjerja e gazit natyror dhe ajrit në turbinën e gazit gjatë diegies së njëpasnjëshme



Një tjetër turbinë e mundshme për ndërtim (djegje jo e njëpasnjëshme).

Figura 1.6 Turbina e gazit me diegie jo të njëpasnjëshme



- Turbina e Avullit** - Turbina e avullit është e një përbërje të kryqëzuar, me tre cilindra të llojit reagues/bashkëveprues; ajo përbëhet nga një seksion i vetëm i presionit të lartë të rrjedhës (HP), një seksion i vetëm i presionit të ndërmjetëm të rrjedhës (IP) dhe një seksion me presion të ulët (LP) me shkarkim lateral/anësor. Fluksi i avullit rrjedh nga gjeneratori i avullit të rikuperimit të nxehtësisë nëpërmjet valvulës së ndalimit dhe kontrollit më anë të difuzorit në seksionin e turbinës HP, ku zgjerohet përmes reaksionit të reagimit për shkak të rinxehjes së


Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

presionit të ftohtë. Pas largimit të seksionit HP përmes lidhjes së shkarkimit, e vendosur në gjysmën e poshtme të shtresës së jashtme, avulli rrjedh në riedukues përmes linjës së ngrohjes së ftohtë. Më pas avulli rrjedh përmes linjës së ngrohjes së nxehtë, futet në seksionin IP përmes dy valvulave të kombinuara të ndalimit dhe kontrollit dhe kalon bllokimin e reaksionit të seksionit IP.

Avulli LP pranohet në shkarkimin e seksionit të IP dhe përzihet me avullin e zgjeruar në seksionin IP. Pasi largohet nga seksioni IP, avulli përmes tubave të kryqëzuar, hyn në seksionin LP ku edhe zgjerohet deri në arrijten e presionin e kondensatorit.

Kondesatori i ftohjes së ujit - Qëllimi kryesor i një kondesatori sipërfaqësor është që të kondensojë avullin e shkarkimit që vjen nga seksion LP (Loë pressure – presion i ulët) i turbinës së avullit (ose të anashkalojë) për të marrë ujë të kondensuar kështu që të mund të ushqehet në gjeneratorin e avullit të rikuperimit të nxehtësisë përmes pompave të nxjerrjes së kondesimit.

Figura 1.7 Kondesatori i ftohësit të ujit



- Gjeneratori i avullit për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG)** - HRSG gjeneron avull për turbinën e avullit, duke shfrytëzuar nxehtësinë e larguar nga shkarkimi i turbinës së gazit (GT). HRSG do të jetë me presion të trefishtë, me rregullim horizontal, qarkullim natyror, mbështetur në llojin më të avancuar, me porta të mëdha avulli dhe për instalim në natyrë.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Figura 1.8 Pamje e gjeneratorit të avullit për rikuperimin e nxehtësisë (HRSG)



- 4) **Gjenerator i zakonshëm për Turbinën me Gaz dhe Avull** - Gjeneratori sinkron 2-polësh me 3 faza është një makineri e vetë-ajrim (ventilim) në sajë të helikave aksiale të vendosura në rotorin dhe kanalet e ventilimit të shpërndara në mënyrë adekuate në qendrën e statorit ftohës dhe në brendësi të dhomave. Këmbyesit e hidrogjenit / ujit të vendosur në mënyrë vertikale në fundet kornizave, ftojnë hidrogjenin e ngrohtë, të nxehur në makineri.

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 1.9 Planimetria e një gjeneratori të zakonshëm për turbinën e gazit dhe turbinën e avullit





Figura 1.10 Pamje 3-D e TEC Korçës



			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

1.2 Fazat e projektit

Aktivitetet e Projektit do të kryhen në tre faza të përshkruara në paragrafet më poshtë.

1.2.1 Faza e Ndërtimit

Faza fillestare e ndërtimit do të përfshijë pastrimin e vegjetacionit, rrethimin dhe nivelimin e vendit, si dhe punimet e gërmimit. Aksesit i zonës së propozuar do të kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të rrugëve ekzistuese të zonës për të ndihmuar lëvizjen e makinerive të rënda, automjeteve, kamionëve dhe transportin e pajisjeve të TEC-it gjatë fazës së ndërtimit. Do të rehabilitohen dy seksione të shkurtra rrugë, Rruga e aksesit Nr. 1 me gjatësi 2550 m dhe Rruga e aksesit Nr. 2 me gjatësi 160 m, të cilat do të përfundojnë gjatë periudhës së përgatitjes së zonës për ndërtim, duke marrë parasysh gjatësinë e tyre të shkurtër.

Tubacioni i gazit do të shtrohet brenda muajve të parë të punimeve ndërtimore dhe lidhja e gazsjellësit me termocentralin do të ndodhë në muajt e fundit të kësaj faze. Gjatë së njëjtës faze do të kryhet ndërtimi i linjës së dyfishtë të transmetimit 400 kV e cila do të lidhë termocentralin më nënstationin Zëmbllak. Komponentët e ndryshëm të projektit (TEC-it) do të shpërndahen, montohen/ bashkohen dhe ndërtohen në zonën e kantierit gjatë një faze të vetme. Ndërtimi i njësive kryesore, turbina me gaz, turbina me avull, kondensatori, HRSG, gjeneratorët, transformatorët, godina ndihmëse e bojlerit më ujë të ngrohtë do të fillojnë të ndërtohen në të njëjtën periudhë, por kohëzgjatja e punimeve dhe montimi do të ndryshojnë në bazë të kërkesave specifike të secilit komponent apo pajisje të TEC-it.

Me kalimin e muajve dhe ndërtimit të objekteve, aktiviteti i në kantier do të zvogëlohet pasi Projekti të kalojë në fazën e para-komisionimit dhe komisionimit ku do të ketë një grup të vogël inxhinierësh dhe teknikësh shumë të kualifikuar që do të kryejnë provat dhe autorizojnë fillimin e punës për termocentralin.

1.2.2 Faza e Funkionimit

Termocentrali është projektuar për të punuar minimalisht 7500 orë në vit dhe më shumë për një jetëgjatësi shërbimi prej 200,000 orë pune. Impianti është projektuar për të arritur një shkallë të lartë të automatizimit dhe operimit të centralizuar duke përdorur një Sistem Kontrolli të Shpërndarë për operimin dhe kontrollin e TEC-it. Impianti do të projektohet për funksionim nga një numër i konsiderueshëm punonjësish të operimit dhe mirëmbajtjes në përputhje me kërkesat për besueshmëri, siguri, fleksibilitet operacional dhe praktikat më të mira.

Teknologjia e parashikuar është BAT (Teknikat më të mira të disponueshme) dhe BREF (Dokument reference i BAT), që përdor teknologjinë e gjenerimit të energjisë së pastër sipas sistemeve të gjenerimit të lëndëve djegëse më efikase, me kosto efektive dhe më pak të dëmshme për mjedisin. Impianti do të pajtohet me të gjitha kërkesat ligjore të publikuara dhe të zbatueshme në Standardin Ndërkombëtar, veçanërisht ligjet mjedisore për shkarkimet e gazta, të lëngëta, emetimet e zhurmave, gjenerimin e mbetjeve, sigurisë së personelit dhe lejeve të ndërtimit. Ngarkesa minimale në impiant përcaktohet me teknologjinë BAT dhe emetimet në ajër. Impianti do të projektohet për të qenë në përputhje me të gjithë kërkesat dhe kushtet e detyrueshme të vendosura nga menaxheri i rrjetit elektrik për lidhjen e impiantit me rrjetin elektrik kombëtar.

  	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Në kushte emergjence, impianti do të funksionojë me Turbinë Avulli (ST) jashtë shërbimi, Turbinë Gazi (GT) në operim, dhe avull të prodhuar nga HRSG-të duke kaluar në kondensator. Impianti do të mund të operojë në të gjitha kushtet klimatike të zonës, duke përmbushur kërkesat e të gjithë klientëve, shkarkimin / shpërndarjen e ngarkesës, fillimin e punës, mbyllja e kontrolluar dhe transmetimin. Impianti do të mund të ndizet, fiket, operojë dhe të mirëmbahet në gjendje të fikur pa dëmtime, në të gjitha kushtet mjedisore të parashikuara në zonë për jetëgjatësinë e projektit të TEC.

Gjatë operacioneve të marrjes dhe vendosjes së makinerive / pajisjeve do të ketë rritje të trafikut në zonë pasi impianti do të kërkojë një shumëllojshmëri shërbimesh. Ky fluks pune do të rritet gjatë periudhave të mbylljeve vjetore dhe periudhave të mirëmbajtjes në shkallë të lartë. Numri i hapjeve të mundësive për punë gjatë fazës së ndërtimit do të jetë përafërsisht 600, duke përfshirë punonjësit dhe nënkontraktimin e kompanive lokale. Gjatë operimit është parashikuar që do të ketë përafërsisht 123 punonjës për operimin e impiantit, mirëmbajtjen në të ardhmen dhe rregullimin periodik vjetor të impiantit.

Përdorimi i Ujit

Kërkesa totale për ujin për ftohje gjatë verës nevojitet të jetë në kufirin e 30°C dhe lagështia Relative (RH) 50% do të jetë 460 m³/orë (128 l/s). Pas procesit të ftohjes në lumin pranë do të shkarkohet rreth 20% e sasisë totale të ujit për ftohje, e cila do të jetë rreth 25 l/s. Burimi kryesor për sigurimin e ujit teknologjik do të jetë impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Korçë që ndodhet pranë vendndodhjes së TEC-it dhe dy puseve shtesë që do të përdoren vetëm në rast emergjence.

Vetëm nevojat për ujë të pijshëm do të sigurohet nga rrjeti i furnizimit me ujë të qytetit të Korçës. Kërkesat për ujë (për kullat e ftohjes dhe sistemin e ftohjes së mbyllur), si dhe kërkesa për ujë për të gjitha proceset e tjera gjatë ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të propozuar do të sigurohen nga uji i trajtuar nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura si dhe përdorimi i ujërave nëntokësore si burim rezervë uji (vetëm në rast emergjence do të nxirret ujë nga dy puset në zonë). Kapaciteti i puseve do të jetë 20-30 l/s secili. Kapaciteti total i impiantit të ujërave të ndotura në 2016 ishte 4,407,813 m³ dhe një mesatare mujore prej 139 l/s.

Trajtimi i Ujit

Ujërat e ndotura të gjeneruara nga veprimtaria e TEC Korçë mund të përfshijnë:

- ujërat e ndotura nga sistemi i trajtimit të ujit;
- ujërat e ndotura nga pompat e vajit të lëndës djegëse, të cilat mund të përmbajnë vaj;
- ujërat e ndotura shtëpiake nga kuzhina dhe kanalizimet.

Sasia e përafërt e ujërave të ndotura urbane (ose ujëra të zeza) do të jetë 15 m³/h. Të gjithë efluentët dhe sasi të ujërave të ndotura urbane do të ndahen dhe do të dërgohen në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotur për trajtim dhe/apo depozitim. Ujërat e ndotura urbane nuk do të shkarkohen pa trajtim paraprak.

Emetimet, Efluentët dhe Mbetjet e Ngurta

Funksionimi i impiantit të propozuar mund të rezultojë në emetime potenciale të SO₂, NO_x, CO₂, VOC-ve dhe grimcave të ngurta në ajër. Megjithatë, turbinat me gaz do të jenë të pajisura plotësisht me një sistem ftohës spërkatës (sprinkler) për të rritur prodhimin e impiantit, i cili njëkohësisht redukton temperaturën e gazeve të shkarkimeve dhe do të rezultojë në reduktim të ndjeshëm të emetimeve të

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

NOx. Për më tepër, pritet që emetimet e gazeve të impiantit të jenë brenda niveleve të lejueshme të shkarkimeve për gazet në përputhje me Direktivat e BE-së, Standardet e IFC dhe ligjet shqiptare.

Burimet kryesore të ndikimeve të mundshme në cilësinë e ajrit të mjedisit gjatë fazës së ndërtimit të projektit të propozuar janë paraqitur më poshtë:

- Gjenerimi i pluhurave për shkak të përgatitjes së zonës së kantierit, punimeve të gërmimit, dhe lëvizjes së makinerive dhe automjeteve;
- Emetime potenciale të SO₂, NO_x, VOC dhe PM₁₀ nga makineritë e ndërtimit dhe automjetet, si dhe nga gjeneratorët statikë që përdoren për prodhim energjie;
- Emetime potenciale të tymit gjatë saldimit dhe VOC-ve nga punimet e saldimit të tubave, pastrimit të sipërfaqeve dhe lyerjes me bojë;
- Emetime potenciale nga magazinimi i lëndëve djegëse, vajrave lubrifikues dhe kimikateve të tjera që çlirojnë VOC.

Gjatë fazës së funksionimit, shkarkimet në ajër do të jenë kryesisht nga burime pikësore stacionare, burimet e lëvizshme dhe burimet fugjitive të emetimeve. Burimet e pikësore stacionare do të përfshijnë kullat e bashkangjitur me Gjeneratorët dhe njësitë HRSG. Burimet e emetimeve fugjitive përfshijnë depozitat, valvolat, fllanxhat dhe lidhjet e tubave. Burimet e lëvizshme përfshijnë automjetet e përdorura për transportin e punëtorëve dhe të materialeve. Ndotësit kryesorë të lëshuar nga burime të tilla përfshijnë NO_x, SO₂, CO, PM₁₀, UHC dhe Komponentet organike të paqëndrueshme (VOCs). Më shumë detaje për shkarkimet e gazeve, sasitë e tyre dhe përqëndrimet do të përfshihen në fazën e vlerësimit të ndikimeve për procesin e VNM.

Gjatë ndërtimit, sasitë më të mëdha të mbetjeve të gjeneruara do të jenë dherat natyralë të tepërt nga procesi i gërmimit. Në lidhje me llojet kryesore të mbetjeve që mund të gjenerohen ato përfshijnë mbetjet ushqimore, mbetjet e zyrave, materiale organike, mbetje të amballazheve të materialeve (plastike, letër, karton, etj), mbetje të vajra për lubrifikim dhe materiale paketimi, etj.

Gjatë funksionimit, sasitë kryesore të mbetjeve të ngurta parashikohen që të jenë mbetjet e gjeneruara nga përdorimi i kimikateve në impiantin e demineralizimit (De-Mi Water) dhe mbetjet e zyrës, duke përfshirë kartonin/letrën, qelqin, mbetjet ushqimore dhe kanaçet. Impianti nuk do të lejohet që të kryejë shkarkime të pakontrolluara të ujërave në mjedis. Është parashikuar që sasi të vogla të mbeturinave të rrezikshme do të gjenerohen në formën e mbetjeve të vajrave/karburanteve, solventë pastrues dhe llum nga rezervuarët e vajit. I gjithë vaji i përdorur do të mblidhet dhe largohet nga vendi dhe do të dorëzohet tek një kompani riciklimi e aprovuar. Së fundi, të gjitha mbetjet e lidhura me punëtorinë do të mblidhen dhe largohen nga vendi i Projektit në vendet e miratuara të depozitimit të mbetjeve.

Shkarkimet aksidentale në zonat e ndërtimit mund të rezultojnë kryesisht nga derdhjet gjatë ngarkim-shkarkimit, transportimit dhe përdorimit të materialeve të rrezikshme. Pastrimi i derdhjeve të tilla gjeneron dhera të ndotur, rrobat e lagura me vaj dhe spastrime të dyshemeve. Në rastet kur përdoren bombola të gazit të ngjeshur ose gazra saldimit, ekziston mundësia e rrjedhjeve aksidentale gjatë ruajtjes dhe përdorimit.

Rreziqet e lidhura me HSD dhe përdorimin e Gazit Natyror

Siguria do të ketë një rëndësi të madhe në projektimin dhe operimin e impiantit, dhe do të hartohen procedurat operacionale për të reflektuar sa më mirë këtë çështje. Elementet e sigurisë do të integrohen në projektimin e impiantit dhe do të përfshijnë valvula ndihmëse, sisteme alarmesh dhe

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

ndeje/fikje, në mënyrë që operatorët të jenë të aftë të zbulojnë situata jonormale apo problematika dhe të reagojnë sipas rastit.

Të gjitha kimikatet e përdorura në zonën e projektit do të ruhen në mënyrë korrekte dhe në sasi minimale. Sode kaustike, acidet, etj., do të ruhen në zona të kufizuara, ndërsa të gjithë kimikatet e tjera do të ruhen dhe përdoren nën praktikë normale të sigurt në enët nën presion përkatëse, tanke ose rezervuarë të posaçëm. Gjithashtu, do të instalohet një sistem i veçantë i kullimit për kimikatet.

Tubacioni dhe pajisjet që mund të jenë objekt i kushteve të ngrirjes (pra në temperatura të ulëta) do të mbrohen në mënyrën e duhur sipas udhëzimeve. Ndrëçimi i nevojshëm i brendshëm dhe i jashtëm do të sigurohet nëpërmjet stacionit të energjisë për të lehtësuar operimin normal dhe aktivitetet e mirëmbajtjes, si edhe mbrojtjen dhe sigurinë. Në rastet kur do konsiderohet e nevojshme do të sigurohet fuqia DC (Kullës Ftohëse) për emergjenca për të bërë mbylljen e sigurt të impiantit dhe ndriçimin gjatë mungesës /shkurtimit të furnizimeve me AC.

Struktura e baterisë do të projektohet për të përfshirë të gjitha rreziqet e shpërthimit, rrjedhjes dhe emetimeve të gazit. Në stacionin elektrik dhe përreth tij do të vendoset një strukturë tokësore për mbrojtjen e pajisjeve dhe stafit; kjo strukturë do të futet në tokë në një thellësi të duhur sipas specifikimeve dhe do të pajiset me elektroda tokësore në një hapësirë të përshtatshme.

Uji për fikjen e zjarrit

Do të sigurohet një sistem për zbulimin e zjarrit i cili mund të rezultojë për shkak të elektricitetit, sistem alarmi dhe mbrojtje për të mbuluar rreziqe të ndryshme për zonën e stacionit të energjisë. Sistemi do të përfshijë depo uji, sistem pompimi dhe shpërndarje, sistem i fiksuar sprucues, sistem spërkatës, rrotull zorrë dhe fikse zjarri të lëvizshme, si dhe një sistem zbulimi. Uji për fikjen e zjarrit do të depozitohet në një seksion të dedikuar të çisternës së zakonshme për depozitim të ujit të patrajtuar dhe një tubacion kryesor tokësor unazor do të shpërndajë ujë nga pompat në zonat e impiantit të mbrojtur nga sisteme me bazë ujin.

Sistemet automatike të sprucimit të ujit me shejptësi të lartë do të ofrohen për të mbrojtur fushat e mëposhtme të impianteve:

- Transformatorët e njësisë;
- Transformatorët e gjeneratorit me turbinë me avull;
- Sistem lënde djegëse me pompim nga bojleri me presion të madh;
- Sistem lënde djegëse për gjeneratorë me benzinë për emergjenca;
- Skelet mbështetës për vaj lubrifikues të turbinave me avull;
- Çisterna depozitimi të lëndës djegëse rezervë;

1.2.3 Faza e Dekomisionimit

Projekti i propozuar ka jetëgjatësi prej 26.67 vitesh. Aktualisht nuk ekziston asnjë marrëveshje që përcakton se çfarë do të ndodhë me objektin në fund të ciklit të jetës, por pritet që vendi i Projektit të kthehet në gjendjen e tij origjinale. Plani i mbylljes dhe restaurimit të zonës do të zhvillohet përpara fillimit të aktiviteteve të nxjerrjes nga përdorimi.

E gjithë infrastruktura do të çmontohet dhe hiqet. Makineritë, hekuri dhe materialet e shkatërruara do të riciklohen aty ku është e mundur dhe do të depozitohen në vendet të aprovuara depozitimi.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

2 Një përshkrim i analizimit të alternativave të mundshme për zbatimin e projektit

Në përputhje me udhëzimet e legjislacionit vendas dhe atyre të institucioneve/organizmave financuese për VNM/VNMS, janë marrë në konsideratë vlerësimet e disa projekteve dhe alternativat e aktiviteteve, me qëllim që objektivat e projektit të propozuar të përfshijnë opsione nga këndvështrimi social, ekologjik, ekonomik dhe teknologjik.

Në këtë paragraf diskutohen alternativat e mëposhtme të projektit:

- Pa Projekt
- Vendndodhja dhe plani alternativ për projektin
- Teknologjitë alternative të prodhimit të energjisë
- Karburant alternativ
- Furnizim alternativ me ujë
- Sistem alternativ i ftohjes
- Kontroll alternativ i emetimeve
- Trajtimi alternativ i ujërave të ndotur

2.1 Pa Projekt

Opsioni “Pa Projekt” nuk është i zbatueshëm, për shkak të kërkesës sociale dhe ekonomike për kapacitet shtesë, për gjenerimin e energjisë në Shqipëri. Projekti është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Energjisë. Po ashtu, siç përmendet më lart, sigurimi i burimit të energjisë për të mbuluar deficietin në prodhimin energjetik është i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik në Shqipëri dhe do të sigurojë diversitetin e mënyrave të prodhimit të energjisë elektrike.

2.2 Vend dhe plan tjetër alternativ për projektin

Projekti i termocentralit me cikël të kombinuar kogjenerimi (CCCPP) që propozohet, do të ndërtohet në tokat të gjelbërta në dispozicion. Si të tilla, nuk ka kërkesa të menjëhershme për të demontuar ndonjë ndërtesë ekzistuese.

Avantazhet kyçe për përzgjedhjen e Korçës si vendndodhje janë:

- Ndërtimi i TEC-it është parashikuar në Master Planin Shqiptar;
- Vendndodhja e CCCPP është dy kilometra larg nga gazsjellësi TAP;
- Nënstacioni elektrik ekzistues në Zëmlak, i cili është në pronësi dhe operohet nga OST Shqiptare (OST sh.a) mund të rrisë transferimin e energjisë elektrike 500 MW në rrjetin elektrik shqiptar;
- Qyteti i Korçës ka nevojë për ngrohje;
- Impianti i Trajtimit të Ujërave të Ndotur (ITUN) i qytetit të Korçës ndodhet pranë projektit të propozuar dhe do të shërbejë si burim kryesor i ujit për ftohje;
- Impianti diellor dhe ITUN ndodhen në afërsi të projektit të propozuar dhe do të mundësojnë përdorimin e infrastrukturës ekzistuese;

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Do të ketë lidhje direkte të ujrave të ndotur të CCCPP me kanalin ekzitues të shkarkimit të ITUN;
- Do të vendoset lidhje ndërmjet ujrave të ndotur dhe ITUN.

Për sa i përket përdorimit të tokës përreth, ai është kryesisht i një lloji industrial. Impianti i energjisë diellore dhe impianti i trajtimit të ujërave të ndotura ndodhet disa qindra metra larg nga vendi i projektit të propozuar.

Si alternativë tjetër, u konsiderua vendndodhja e termocentralit të vjetër të Korçës. Kjo vendndodhje nuk ka avantazhe mbi atë të propozuarën por dy dizavantazhe të mëdha: nuk ka burim të ujit për ftohje dhe përgatitja e terrenit ka kosto të lartë (demontimi i objekteve dhe themeleve ekzistuese).

Për sa i përket vendndodhjeve të mundshme alternative, kuptohet që asnjë vend tjetër nuk është konsideruar sepse vendndodhja e propozuar ka kaq shumë përparësi dhe është konsideruar si optimale dhe e përshtatshme teknikisht.

2.3 Teknologjitë alternative të prodhimit të energjisë

Është konsideruar impianti alternativ me qymyr. Impianti me qymyr nuk është opsion, sepse qymyri është lëndë djegëse "e pisët" me ndotje shumë të lartë kur nxirret, ruhet apo kur digjet dhe ka probleme të mëdha se si të magazinohen dhe trajtohen nënproduktet (hiri, skorjet, amoniaku, gëlqerori, gips). Qymyri gjithmonë ka emetime të pluhurave dhe SOx. Emetimi i CO₂ nga termocentrali me qymyr është shumë i lartë, pothuaj dyfishi në krahasim me impiantin me gaz. Koeficienti neto i efikasitetit për teknologjinë më të mirë të qymyrit është 46-47% dhe është drastikisht më i ulët në krahasim me impiantin me cikël të kombunuar të turbinës me gaz, që sot arrin në 61-62%.

Është konsideruar alternativa konvencionale e bojlerit me turbinë me avull. Kjo teknologji e vjetër ka koeficient të efikasitetit rreth 20% më të ulët në krahasim me teknologjinë me cikël të kombinuar të turbinës me gaz dhe është i papranueshëm për këtë projekt.

Madhësia e vendit të projektit është e përshtatshme për një kombinim të ngrohjes dhe termocentralit (CHP), megjithatë, përzgjedhja e teknologjisë me turbinë gazi me cikël të kombinuar (CCGT) është preferuar për një numër arsyesh duke përfshirë efikasitetin e tij më të lartë, fleksibilitetin, besueshmërinë dhe efektivitetin e kostos. Konsiderohet se teknologjia e ciklit të kombinuar të turbinës me gaz, ka në përgjithësi më pak ndotje sesa motorët reciprokë për sa i përket emetimeve.

Po ashtu roli kryesor i stacionit energjetik dhe nevojat e vendit për energji ndikojnë në procesin e përzgjedhjes. Aktualisht, me teknologjinë e CCGT kërkesat e ngarkesës janë plotësuar, aq mire sa për të siguruar që periudhat e kërkesës maksimale mund të mbulohen.

Projekti i propozuar do të funksionojë me mënyrën e kogjenerimit me cikël të kombinuar dhe do të përdorë gazin natyror si burim energjie. Këto teknologji janë provuar teknikisht dhe komercialisht në periudha të gjata dhe janë bërë më efikase duke përfshirë edhe teknologjitë e zbutura për të ulur më tej ndikimet në mjedis.

					
		<i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>			
Kompania	Abkons sh.p.k				
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)				

3 Përshkrim i gjendjes dhe vlerave ekzistuese të mjedisit, që mund të ndikohen nga zbatimi i projektit të propozuar

3.1 Përshkrimin e karakteristikave fizike të zonës së projektit

3.1.1 Përshkrim të faktorëve klimatikë

Zona e studimit i përket klimës së nën-zonës Jugore Mesdhetare Para-malore. Sipas të dhënave në dispozicion, vërehet se temperaturat e ajrit janë më të ftohtat në Shqipëri, ku ka një ndikim të rëndësishëm kontinental. Temperatura mesatare vjetore në Korçë është 10.5°C, me temperaturë mesatare prej 20°C në korrik dhe temperaturë mesatare 0.5°C në janar. Korça regjistron temperaturat më të ulëta në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë për shkak të depërtimit të masave të ftohta ajrore.

Tabela 3-1 Temperatura mesatare mujore dhe mesatare vjetore e ajrit (°C) (1951 – 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shta	Tet	Nën	Dhje	Mesatarja Vjetore
Korçë	0.5	2.2	4.9	9.2	13.9	17.6	20	20.2	16.5	11.3	6.8	2.5	10.5

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 3-2 Temperatura minimale absolute e ajrit (°C) (1951 – 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën	Dhje	Minimale Absolute
Korçë	-20.9	-17.3	-16.5	-10.5	0	2.6	4.9	6.6	-0.5	-7.5	-10.2	-19	-20.9

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 3-3 Temperatura maksimale absolute e ajrit (°C) (1951 – 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën	Dhje	Maksimale Absolute
Korçë	17.4	21.8	26.3	26.7	31.6	34.3	38.7	36.5	33.1	27.6	25	18.1	38.7

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Sipas të dhënave të rreshjeve, zona karakterizohet nga rreshje të ulëta në krahasim me rajonet e tjera të Shqipërisë. Gjithashtu, vërehet një shpërndarje gjeografike jo e rregullt rreshjeve vjetore. Në verë, rreshjet përfaqësojnë vetëm 13.4% të rreshjeve vjetore, si rezultat i ndikimit të klimës kontinentale. Ndërkohë që, precipitimet e borës ndodhin më së shpeshti në periudhën Nëntor-Prill.

					
		<i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>			
Kompania	Abkons sh.p.k				
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)				

Tabela 3-4 Sasia mujore dhe sezonale e rreshjeve (mm) (1951 - 1990)

Stacioni	Muaji											
	Dhje	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën
Korçë	98	78	73	59	60	74	43	32	31	48	85	109
	Sezoni											
	Dimër			Pranverë			Verë			Vjeshtë		
Korçë	249			193			106			242		
	Totale (Vjetore) = 790											

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 3-5 Numri i ditëve me rreshje (1951 - 1990)

Stacioni	Ditët		
	Rreshje ≥ 0.1 mm	Rreshje ≥ 1 mm	Rreshje ≥ 10 mm
Korçë	130.7	94.1	25.8

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 3-6 Numri i ditëve me borë sipas muajve dhe totali vjetor (1951 - 1990)

Stacioni	Jan	Shku	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gush	Shtat	Tet	Nën	Dhje	Totali (vjetor)
Korçë	12.3	11.4	3.8	5.3	-	-	-	-	-	-	0.7	6.3	34.8

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Tabela 3.7 tregon frekuencën (f) dhe shpëjtësinë (sh) e erës sipas drejtimeve të ndryshme në stacionin e monitorimit të IHMSH me vendodhje në Sheqeras.

Tabela 3-7 Drejtimet e erave të matura në stacionin e Sheqeras, Korçë


Stacioni	Periudha e qetë (%) (Wind Calm)	V		VL		L		JL		J		JP		P		VP	
		f	sh	f	sh	f	sh	f	sh	f	sh	f	sh	f	sh		
Sheqeras, Korçë	10.4	14.9	3.4	5.3	2.8	28.9	4.7	8.2	3.9	4.8	4.1	2.6	2.6	6	3.3	18.9	3.7

Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Erat

Figura 3.1 Trëndafili i erave në Sheqeras, Korçë



Burimi: Insitituti Hidrometerologjik i Shqipërisë (IHMSH)

Sipas të dhënave të paraqitura më sipër, në Korçë dominojnë erërat nga Veri-Perëndimi dhe Lindja. Shpejtësitë mesatare të erës të regjistruara në stacionin e meteorologjik të Sheqeras (11.5 km distancë ajrore nga zona e studimit) variojnë nga 2.6 m/s në 4.7 m/s, brenda intervaleve të ilustruara në figurën e mësipërme.

3.1.2 Përshkrim gjeomorfologjik dhe të sizmitetit të zonës së projektit

Zona e studimit është më së shumti e rrafshët, duke pasur një tendencë veri – perëndimore prej 1%. Ngritja varion nga 820m – 840m mbi nivelin e detit (m.n.d). Drejt zonës jugore (Mborje), relievi ngrihet mbi 1700m m.n.d, duke ndërtuar shpate të pjerrëta veri – perëndimore.


3.1.3 Përshkrim të gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit

TEC-i Korçës është propozuar të ndërtohet në skajin lindor të Qytetit të Korçës. Gjeologjia e zonës së studimit konsiston në sediment aluviale kuaternare, formacione mollasike Burdigaliane, gurë gëlqerorë të periudhës së Kretakut dhe shkëmbinj ultrabazikë. Sedimentet kuarternare që janë më së shumti të tipit aluvial dhe të shpërndara përgjatë zonës së rrafshhtë konsistojnë në zhavorr dhe rërë të ndërlidhur me shtresa argjilore dhe të mbuluara nga sedimente argjilore ranore. Formacionet shkëmbore janë të përfaqësuara nga molaset Burdigaliane, gurët gëlqerorë të periudhës së Kretakut dhe ultrabazikët e Jurasikut, të cilët dalin mbi sipërfaqen e tokës së bashku me terrenet kodrino-malore veri-lindore.

Formacionet mollasike konsistojnë në ndërlidhjen e gurëve ranorë (me fortësi të butë deri në mesatare)/ alevorlitë ranorë, shtresa shkëmbinjësh ranorë/konglomeratë. Travertina (guri gëlqeror) është i shtresëzuar dhe në strukturë porcelani, i karstifikuar intesivisht. Ultrabazikët janë shkëmbinj të fortë. që alterohen më së shumti në serpentina, të copëzuar dhe tektonikë.

  	
LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards	
Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Figura 3-1: Harta Gjeologjike e rajonit të Korçës, shkalla 1:100000






3.1.4 Përshkrim të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit

Zona përreth territoreve të Korçës dhe zonës së propozuar për zhvillim është drenazhuar nga një lum i madh, lumi Devoll. Në zonën e Korçës ka burime të tre lumenjve të Shqipërisë (Devoll, Shkumbin dhe Osum). Lumi Devoll rrjedh fillimisht në verilindje, përmes Miras, pastaj në veri përmes Bilishtit dhe në veriperëndim përmes Progërit, Pojanit (në veri të Fushës së Korçës), Maliqit, Moglicës, Kodovjatit, Gramshit, ku ndodhet një liqen i madh dhe Gostimë, ku kthehet në drejtim të jugut. Ai bashkohet me lumin Osum pranë qytetit të Kuçovës, për të formuar Semanin.

Uji i këtij lumi përdoret kryesisht për bujqësi dhe për përdorime të ndryshme shtëpiake. Përgjatë rrjedhës së tij, raportohet se shkarkohen ujëra nga industritë, ujëra të ndotura shtëpiake dhe ujë të trajtuar. Lumi Devoll kalon në afërsi të fshatit Zëmbllak, ku do të ndërtohet linja e transmetimit në nën-stacionin e Zëmbllakut. Është afërsisht 10 km në distancë ajrore nga vendi i propozuar për TEC Korçën.

Një çështje e rëndësishme për tu marrë në konsideratë për ujërat sipërfaqësore janë kanalet e kullimit dhe kanalet e ujitjes të zonës. Një kanal kullimi ndodhet në pjesën perëndimore të vendit të propozuar

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

për zhvillimin e TEC-it. Ky kanal nënkuptohet se ushqehet/përdoret nga impianti i trajtimit të ujërave të zeza.

Zona e Korçës është e pasur me burime ujorë nëntokësore. Në zonën e studimit janë të pranishëm 3 tipe akuiferesh:

- Akuiferi aluvial intergranular me transmetim mesatar;
- Akuiferi gëlqeror me çarje karstike;
- Akuiferi me çarje të lidhur me shkëmbinj të ultrabazikë..

Figura 3-2: Pamje nga pusi I vëzhguar gjatë studimit në terren



Akuiferi aluvial intergranular i transmetimit mesatar

Ky akuifer përhapet përgjatë dispersionit të brëndshëm të Korçës dhe është i klasifikuar si një akuifer ujë-mbajtës me potencial mesatar. Është i përbërë nga sedimente aluviale të lumit të Devollit e Dunavecit dhe është rreth 196 km i gjatë.

Konsiston në 4 – 8 shtresa zhavorri duke krijuar një trashësi totale prej 11 – 12m. Sedimentet ujë-mbajtëse variojnë në kompozim, nga më së shumti zhavorr (nga periferia jugore drejt qendrës) tek më së shumti rërë (nga qendra drejt pjesëve jugore të akuiferit).

Të gjitha horizontet ujë-mbajtëse janë të kufizuafra dhe përmbajnë ujëra nëntokësorë artesian. Nivelet piezometrike variojnë nga 2 deri në 22 m mbi nivelin e sipërfaqes së tokës dhe më të lartat janë gjetur në zonën Turan – Bulgarec (3 – 19m mbi nivelin e sipërfaqes së tokës).

Prodhimtaria specifike varion nga 0.3 l/sek/m në sektorë jugorë, përmes 2 – 5l/sek/m në qendër të akuiferit, deri në 0.3 – 1.4 l/sek/m në sektorët veriorë. Vetërrjedhja e puseve artesiane varion nga 0.5 – 5 l/sek në 20 – 57 l/sek.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Gradienti hidraulik (I) për shtresat 1 – 4 është rreth 0.02. Rrjedhja dinamike e akuiferit është vlerësuar të jetë rreth 520 m³/ditë. Drejtimi kryesor i rrjedhës së ujërave nëntokësorë është nga jugu në veri. Burimi kryesor i ringarkimit për akuiferin aluvial të Korçës është infiltrimi i ujit të precipituar nga sektorët jugorë ku shtresat e zhavorrit ekspozohen dhe në një shtrirje më të ulët nga akuiferët lindorë.

Akuiferi gëlqeror me çarje karstike

Akuiferi me çarje karstike është i lidhur me gëlqerorët e Kretakusit të cilët kanë përhapje të limituar dhe tejkalojnë në zonën e Zëmbllakut. Gëlqerorët janë të përfshirë në procesin e karstit i cili i ka prekur ato në përhapje të ndryshme. Ky akuifer tregon vlera transmetimi variabël bazuar në intensitetin e karstit. Përcjellshmëria hidraulike e akuiferit karstik varion nga 0.6 në 0.7m/ditë.

Akuiferi me çarje të lidhur me shkëmbinj të ultrabazikë

Ky akuifer është i lidhur me Jurasikun Mesatar (J2), shkëmbinj ultrabazikë të cilët tejkalojnë në sektorët jugorë të depresionit të Korçës.

Ultrabazikët janë të çarë intensivisht veçanërisht në pjesën më të lartë 100 – 200m në sipërfaqen e tokës. Në këtë lloj akuiferi janë dalluar 2 horizonte hidrodinamike:

- Horizonti i sipërm (mbi 100 – 200 m) i cili është i çarë intensivisht dhe karakterizohet nga dinamika të larta ujore
- Horizonti i poshtëm me lëvizje të ulëta të ujërave nëntokësorë

Potenciali i tyre ujqor është i variueshëm bazuar në sistemin e tyre të copëzimit. Përgjatë kontaktit të shkëmbinjëve ultrabazikë me sedimentet e depresionit të Korçës, ngrihen disa burime me prodhimtari 0.1 – 3 l/sek.

Kushtet e pritshme të përshkrueshmërisë të lidhura me njësitë e ndryshme gjeologjike

Zhavorri aluvial. Zhavorri është i karakterizuar nga poroziteti intergranular. Karakteristikat e përshkrueshmërisë së tyre variojnë në sektorë të ndryshëm të përhapjes së zhavorrit duke treguar një tendencë të qartë të vlerave që ulen në përshkrueshmëri nga sektorët jugorë (zona e furnizimit) drejt zonave veriore (zonat e shkarkimit) dhe pasjen e vlerave maksimale në qendër të akuiferit.


Kështu, përcjellshmëria hidraulike varion nga 4m/ditë në sektorët jugorë, përmes 15 – 64 m/ditë në qendër të akuiferit, deri në 3 – 28 m/ditë në sektorët veriorë. Vetërrjedhja e puseve arteziane varijon nga 0.5 – 5 l/sek deri në 20 – 57 l/sek.

Gëlqerorët. Ato përmbajnë akuifere të çarë karstikë që përmbajnë sasi të mëdha ujërash nëntokësorë. Përcjellshmëria hidraulike e akuiferit karstik varion nga 0.6 – 0.7 m/ditë.

Ultrabazikë. Ato përmbajnë akuifere porozë të çarë. Tiparet e përshkrueshmërisë janë të ndryshme përgjatë thellësisë. Ato janë më të larta në horizontin e sipërm hidrodinamik dhe ulët në horizontin e poshtëm (>200m).

			
		<i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>	
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Figura 3-3: Harta hidrogjelogjike e rajonit të Korçës, shkalla 1:500000







3.2 Përshkrimin e biodiversitetit në zonën e projektit

3.2.1 Përshkrim të habitateve kryesore në zonën e projektit

Për projektin e propozuar, studimi i gjendjes ekzistuese është zhvilluar brenda zonës së influencës, në një rreze mbi 2 km nga vendi i propozuar për termocentralin dhe në një korridor 0.5 km të gjerë (0.25 km nga secila anë e linjës së propozuar). Gjurma e kalimit të tubacionit së gazsjellësit është i lokalizuar në anën e majtë të rrugës rurale dhe kalon më së shumti përmes tokave bujqësore të kultivuara me jonxhë, misër dhe grurë. Tubacioni i ri i gazsjellësit do kalojë paralel me kanalën e drenazhimit të zonës (e lokalizuar në anën e djathtë të rrugës rurale) i cili drenazon ujin e trajtuar nga Impianti i Trajtimit Të Ujit të Ndotur të Korçës. Kanali kryesor i drenazhimit është i populluar më shumti me disa lloje kallamishtesh (*Typha latifolia*, *Phragmites australi*) dhe lulëkuqe (*Sparganium erectum*). Përgjatë kanalit të drenazhimit mund të hasen edhe disa plepa (*Populus canadensis*). Në përgjithësi, të gjitha speciet e vëzhguara në këtë lloj habitati (toka bujqësore) janë të zakonshme dhe nuk kanë status ruajtje kombëtar apo ndërkombëtar. Vetëm disa nga këto kanë statusin LC (Least Concern)/ (Më pak të shqetësurat) sipas IUCN.

			 LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Figura 3-4: Foto ilustruese të florës në zonën e projektit (gazsjellësi, rrugët e aksesit dhe termocentrali)

 <p>Toka bujqësore dhe të braktisura në zonën ku do të ndërtohet termocentrali me gaz i Korçës</p>	 <p>Kanalet e drenazhimit dhe tokat bujqësore të përfaqësuara nga disa tipe specie të florës. Gazsjellësi i propozuar shkon paralel me kanalën e drenazhimit.</p>
 <p>Kanal drenazhimit dhe toka bujqësore të përfaqësuara nga disa specie të florës. Gazsjellësi do ndërtohet përgjatë këtyre parcelave.</p>	 <p>Kanal drenazhi dhe toka bujqësore të përfaqësuara nga disa nga speciet e florës. Gazsjellësi do ndërtohet përgjatë këtyre parcelave.</p>

3.2.2 Përshkrim të vegjetacionit në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre

Sikurse u përmend, si për florën, edhe për faunën, studimi i gjendjes ekzistuese për projektin e propozuar është zhvilluar brenda zonës së influencës, në një rreze mbi 2 km nga vendi i propozuar për termocentralin dhe në një korridor 0.5 km të gjerë (0.25 km nga secila anë e linjës së transmetimit të propozuar). Tipet e vegjetacionit të vëzhguar dhe habitatet e hasura brenda kësaj zone përfshijnë:

- toka bujqësore dhe të braktisura;
- vegjetacion në kanalet e drenazhimit dhe kullimit;
- pyje, zona me kopshte zburkuese dhe kullota gjysmë natyrore;
- plantacione për aktivitete shtëpiake .

Zona ku propozohet të ndërtohet termocentrali përfaqësohet nga toka të braktisura dhe toka bujqësore ku janë kultivuar bimë të ndryshme si: jonxhë, miser, grurë apo pemë frutore molla dhe kumbulla). Parcelat e tokave brenda zonës së propozuar për termocentralin me gaz, janë të rrethuara me kanale dreanzhimi dhe kullimi të populluara më së shumti nga: kallamishte të llojeve (*Typha latifolia*, *Phragmites australi*) dhe lulëkuqe(*Sparganium erectum*).

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Linja e Transmetimit do kalojë përmes tokave bujqësore të fshatrave Malavec, Shamoll, Plasa dhe Zëmbllak. Këto toka bujqësore janë më së shumti të përfaqësuara nga toka të kultivuara me jonxhë, grurë, bimë mjeksore, misër dhe pemë frutore (molla dhe kumbulla). Parcelat e këtyre tokave janë të rrethuara me kanale drenazhimi dhe kullimi, të populluara më së shumti me lloje kallamishtesh dhe lulekuqe sikurse u përmendën më sipër. Speciet e bimëve medicinale mund të përfshijnë *Salvia officinalis*.

Barërat janë një element përbërës, i zakonshëm, në këto toka. Speciet që dallohen janë: Zhabinë misri (*Ranunculus arvensis*), lulëkuqe (*Papaver rhoeas*), Trasta e çobanit (*Capsella bursa-pastoris*) janë kultivime të shpeshta në dimër. Toka të pasura me azot të tipit: *Polygonum arenaria*, *Amaranthus hybridus*, *Atriplex patula*, *Chamomilla recutita*, *Chenopodium vulvaria* janë kultivime më së shumti verore.

Figura 3-5: Foto ilustruese të florës në zonën e projektit (zona ku kalon linja e transmetimit)

 <p>Toka bujqësore, pranë stacionit elektrik të fshatit Zëmbllak.</p>	 <p>Toka bujqësore, pranë fshatit Plasë</p>
 <p>Vegjetacioni i përroit të Dishnicës</p>	 <p>Vegjetacioni lumit Devoll; kallamishte të tipit (<i>Sparganium erectum</i>) dhe (<i>Scirpus lacustris</i>). Kjo pikë është e lokalizuar jashtë zonës së projektit, gjithsesi brenda zonës së influencës</p>

Biodiversiteti i specieve të florës dhe Përcaktimi i Statusit Ekologjik

Tabela 3-8 Statusi ekologjik i specieve të florës

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Nr.	Emri shkencor	Emri shqipëtar	Statusi i konservimit	Shënime
1	<i>Aesculus hippocastanum</i>	Gështenjë kali, gështenjë e egër	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi CR A1a.	E identifikuar brenda zonës së influencës por nuk ndikohet nga aktivitetet e ndërtimit të Projektit.
2	<i>Betula pendula</i>	Mështeknë e bardhë	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi CR B2e.	E identifikuar brenda zonës së influencës por nuk ndikohet nga aktivitetet e ndërtimit të Projektit.
3	<i>Butomus umbellatus</i>	Bliqen, lule shtërgu	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi VU A1b.	E identifikuar brenda zonës së influencës por nuk ndikohet nga aktivitetet e ndërtimit të Projektit. Gjatë fazës së ndërtimit, kontraktori do sigurohet që zona nuk do ndikohet nga punimet e ndërtimit, aktivitetet e transportit apo ndonje aktivitet tjetër që lidhet me projektin.
4	<i>Hypericum perforatum</i>	Lulebasani, balc	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi EN A1b.	E identifikuar brenda zonës së influencës dhe zonës së projektit, ku do kalojë Linja e Transmetimit. Kjo specie është vëzhguar anën lindore të një shtylle elektrike, për afërsisht 100 m në distancë ajrore. Gjatë fazës së ndërtimit, kontraktori do sigurohet që zona nuk do ndikohet nga punimet e ndërtimit, aktivitetet e transportit apo ndonje aktivitet tjetër që lidhet me projektin.
5	<i>Juglans regia</i>	Arrë, kaçkë	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi EN A1b.	E identifikuar brenda zonës së influencës por nuk ndikohet nga aktivitetet e ndërtimit të Projektit.
6	<i>Juniperus communis</i>	Dëllinjë e zezë	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi VU A1b.	E identifikuar brenda zonës së influencës por nuk ndikohet nga aktivitetet e ndërtimit të Projektit.
7	<i>Juniperus oxycedrus</i>	Dëllinja e Kuqe	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi VU A1b.	E identifikuar brenda zonës së influencës por nuk ndikohet nga aktivitetet e ndërtimit të Projektit.

			 LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Nr.	Emri shkencor	Emri shqipëtar	Statusi i konservimit	Shënime
8	<i>Pinus sylvestris</i>	Hartinë	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi CR A1b.	E identifikuar brenda zonës së influencës por nuk ndikohet nga aktivitetet e ndërtimit të Projektit.
9	<i>Tilia platyphyllos</i>	Bli gjethegjërë, bli llapush	Lista e Kuqe Shqipëtare me status konservimi CR A1c.	E identifikuar brenda zonës së influencës por nuk ndikohet nga aktivitetet e ndërtimit të Projektit.

3.2.3 Përshkrimin e zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti, përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj

Zona në studim është e përfshirë në një territor me karakter urban, me prezence infrastrukture, e cila është e lidhur me një patern kultivimi kompleks. Gjatë vëzhgimeve të bëra në terren, nuk pritet të ketë ndikime potenciale nga ndërtimi dhe operimi i TEC-it të Korçës. Gjithsesi, 3 janë zonat e evidentuara në një distancë të konsiderueshme nga projekti i propozuar:

- **Parku Kombëtar “Bredhi i Drenovës”** – Ndodhet në pjesën Juglindore të TEC-it, përafërsisht 6.9 km në distancë ajrore;
- **Zona e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhueshme “Cangonj”** – Ndodhet në pjesën Verilindore të projektit të propozuar, përafërsisht 10 km në distancë ajrore;
- **Zona e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhueshme “Krastafillak”** – Ndodhet në pjesën Veriperëndimore të projektit, përafërsisht 8.7 km në distancë ajrore.

Gjithashtu, është zhvilluar një studim për Zonat e Veçanta të Ruajtjes së Interesit, të cilat janë të identifikuar me “Rrjetin Emerald” (ASCI). Identifikimi nga ASCI është bërë gjatë periudhës 2002 – 2008 në Shqipëri dhe si rezultat janë 25 zona potenciale “Emerald” ku ndër to edhe “Peisazhi i Mbrojtur i Moravia”. Sipas VKM Nr. 31, datë 20.01.2016 “Për adaptimin e një dokumenti politik për mbrojtjen e biodiversitetit”, zona me “Peisazhi i Mbrojtur i Moravia” (e vlerësuar në Kategorinë 4 sipas IUCN), e cila përfshin edhe “Parkun Kombëtar ‘Bredhi i Drenovës’” dhe Zonën e Mbrojtur të Burimeve të Menaxhueshme Cangonj, është propozuar i tëri si territor si zonë e mbrojtur, por nuk është aprovuar akoma. Gjithsesi, nëse marrim në konsideratë distancën nga Projekti, është afërsisht 1.55 km në distancë ajrore.

Janë 2 monumente natyrore të identifikuar jashtë zonës së influencës dhe në distancë të konsiderueshme nga aktiviteti i propozuar:

- Rrepet e Qytetit (Shënmëria) – Monument natyror afërsisht 2.4 km në distancë ajrore nga TEC-i i propozuar në pjesën jugperëndimore të tij. Koordinatat (UMT) janë:

E: 0481110.20

N: 4496722.14

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Pisha e Shëndëllisë – Monument natyror afërsisht 3.9 km në distancë ajrore nga TEC-i i propozuar në pjesën juglindore të tij. Koordinatat (UMT) janë:

E: 0484445.01

N: 4496036.09

3.3 Përshkrimin e cilësisë së mjedisit

Akuiferi aluvial intergranular

Uji nëntokësor artezian i akuiferit aluvial ka tipare të mira fiziko – kimike. Përmbajtja e NO₂, NH₄ e NO₃ në Potgorie dhe Bulgarec është brenda vlerave të lejuara. Fortësia e përgjithshme varion nga 8.51 – 8.960°dH (Bulgarec) deri 18.8 – 17.920°dH (Terove) që karektarizon ujërat nëntokësor si mesatarisht të fortë. Përmbajtja totale e materialeve të ngurta të tretura varion nga 369.23 – 397.99 mg/litër (Libonik) deri 543.47 – 541.61 mg/liter (Sheqeras). Uji nëntokësorë është pak alkaline me vlera pH që variojnë nga 7.2 deri 7.8.

Akuiferi gëlqeror me çarje karstike

Uji nëntokësor është i freskët, pa erë, pa ngjyrë dhe pa shije. Temperatura e ujit nëntokësor varion nga 9 to 15°C. Përmbajtja totale e materialeve të ngurta të tretura varion nga 0.205 në 0.423 gr/litër, ndërsa fortësia e përgjithshme varion nga 11 deri 15°dH. Përbërja e ujit nëntokësor i përket tipit të hidro – kimikateve kalcium – bikarbonat dhe më rrallë kalcium – magnez – bikarbonat.

Akuiferi me çarje të lidhur me shkëmbinj të ultrabazikë

Uji nëntokësor është i freskët, pa erë, pa ngjyrë dhe transparent. Temperatura e ujit nëntokësor varion nga 11 në 14°C. Përmbajtja totale e materialeve të ngurta të tretura varion nga 0.176 to 0.436 gr/litër ndërsa fortësia e përgjithshme varion nga 11 në 15°dH. Përbërja e ujit nëntokësor i përket tipit të hidro – kimikateve magnez – bikarbonat.

Nuk ka të dhëna për kontaminim të ujërave nëntokësorë në zonën e studimit. Akuiferi më vulnerabël për kontaminimin e sipërfaqes duhet të jetë akuiferi karstik që përbëhet nga gëlqerorët. Në zonën tonë të studimit, gëlqerorët kanë përhapje të limituar dhe ato tejkalojnë në kodrat ku nuk ka aktivitete njerëzore dhe si pasojë kjo ul rrishtun që ujërat e tyre nëntokësorë të kontaminohen.

Akuiferi aluvial që përfaqëson furnizuesin me ujë më të rëndësishëm shtetëror (dhe privat) për zonën e Korçës, është më së shumti i mbrojtur nga kontaminimi sipërfaqes falë prezencës së mbulesës së papërshkrueshme të argjilës ranore, e cila është e konfirmuar nga prania e ujit në stanjacion në pishina dhe kanale të braktisura. Për më tepër, karakteri i tij me shumë shtresa, ku shtresat e zhavorrit ujë – mbajtës janë të ndara me shtresat argjilore të papërshkrueshme dhe nuk komunikojnë me njëra – tjetrën hidraulikisht, duke e bërë më të sigurtë nga kontaminimi i sipërfaqes.

Uji nëntokësor në akuiferin me çarje të shkëmbinjëve ultrabazikë nuk duhet të kontaminohet për të njëjtat arsye si akuiferi karstik. Ky akuifer ndodhet në terrenet e larta në pjesën jugore të zonës së studimit. larg nga aktiviteti njerëzor ditur.

Duke iu referuar informatave zyrtare, gjatë sezonit të dimrit në qytetin e Korçës ka emetime të tymrave dhe grimcave të ngurta për shkak të përdorimit të madh të sobave me dru nga banorët. Një kontribues tjetër i emetimeve në ajër është lëvizja e lartë e automjeteve në qytet për shkak të rritjes së turizmit gjatë gjithë periudhës së vitit. Përsa i përket zonës së projektit dhe qytetit të Korçës, parametrat

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

e cilësisë së ajrit parashikohen të jenë më të mira gjatë sezonit të lagësht për shkak të rreshjeve të shiut, i cili largon ndotësit në ajër.

Zhurma ekzistuese antropogjene në zonë është e lidhur me aktivitetet bujqësore dhe shtëpiake. Një kontribues për nivelet aktuale të zhurmës në zonë vjen si pasojë e lëvizjes së automjeteve përgjatë rrugëve të aksesit në impiantin e trajtimit të ujerave të ndotura të Korçës. Aktualisht, në zonën e propozuar nuk u vërejtën burime të vibrimeve gjatë vizitës në terren. Zona gjithashtu ndriçohet përgjithësisht gjatë natës për shkak të funksionimit të impiantit të trajtimit të ujerave të ndotura.

Në terma rajonale, Komuna e Korçës menaxhon mbeturinat komunale me anë të dy stacioneve të transferimit dhe një deponi sanitare të vendosur në Maliq. Megjithatë, janë vëzhguar disa zona të ndotura me mbetje urbane dhe inerte, të cilat mendohet të jenë gjeneruar nga banorët vendas gjatë aktiviteteve të përditshme të punës, aktiviteteve bujqësore dhe aktiviteteve të mëparshme të gjurmimit.

Duke iu referuar zonës së propozuar të projektit GPP Korça, gjatë vëzhgimit në terren janë identifikuar disa zona të ndotura me mbetje urbane dhe inerte. Në përgjithësi, lloji i mbetjeve të vëzhguara gjatë studimit në terren përfshin mbeturinat inerte, mbetjet bujqësore (si qese plastike të fertilizuesve) dhe mbetjet urbane (plastika, kartona, mbetje organike, rroba, etj.).

Zonat kryesore të ndotura janë:

- Rruga kryesore rurale e cila siguron hyrjen në Impiantin e Trajtimit të Ujerave të Ndotura dhe zonën e propozuar për ndërtimin e termocentralit të gazit; përfaqësohet në PK 0 + 470 të kësaj rruge është vërejtur një sasi e madhe e mbetjeve inerte (rreth 800 m³).
- Kanali kryesor i kullimit të zonës, i vendosur në anën e djathtë të rrugës bujqësore; mbetjet urbane dhe bujqësore janë vërejtur në disa pika të vëzhguara përgjatë këtij kanali kullues.

3.4 Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti

3.4.1 Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti

Projekti i termocentralit të Korçës, shtrihet në Bashkinë e Korçës dhe në Bashkinë e Maliqit. Zonat që do të ndikohen më shumë është Qyteti i Korçës (Njësia Administrative Korçë) dhe fshatrat Kuç i Zi, Belorta, Dishnicë, Barç, Malavec, Neveçisht, që bëjnë pjesë në Njësinë Administrative Qëndër Bulgarec. Ndërsa Bashkia e Maliqit do të ndikohet nga një pjesë e rrjetit të transmetimit të energjisë elektrike, drejt nënstacionit të Zëmplakut. Fshatrat që do të preken janë Plasë dhe Zëmplak dhe bëjnë pjesë në Njësinë Administrative Pojan.

3.4.2 Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës

Popullsia e Bashkisë së Korçës, sipas Censurit të vitit 2011, numëron prej 75.994 banorë, ndërsa sipas Regjistrimit Civil ajo numëron një popullsi prej 129.065 vetë. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 805.99 km². Kjo bashki përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Korçë, Qendër Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Korçës dhe qarkut Korçë. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 62 fshatra.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Qyteti ka një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta, por rritja e numrit të popullsisë si pasojë e zhvendosjes së banorëve nga zonat rurale ka sjellë edhe rritje të numrit të personave të papunë duke ngritur domosdoshmërinë e gjetjes së zgjidhjeve për punësim dhe kualifikimin e këtyre personave për profile të ndryshme.

Në zonat rurale janë zhvilluar nga njëra anë bujqësia dhe pemëtaria, dhe nga ana tjetër turizmi malor ku banorët kanë vetë-siguruar mënyrën e organizimit të ambienteve dhe kuzhinës por edhe aktiviteteteve dimërore si një atraksion për turistët.

Për sa i përket popullsisë së Bashkisë së Maliqit, sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re numëron 41,757 banorë, ndërsa sipas Regjistrat Civil kjo bashki numëron një popullsi prej 64,664 persona. Bashkia e re ka një sipërfaqe prej 656.34 km². Densiteti i popullsisë sipas censurit është 64 banorë/km² ndërsa sipas regjistrat civil është 99 banorë/km².

Bashkia e Maliqit shtrihet në një nga zonat më pjellore bujqësore të Shqipërisë, më së shumti në një ish-kënetë të tharë me shumë mund dhe sakrifica njerëzore në vitet 1950. Qyteti i Maliqit u krijua si një qendër e rëndësishme e industrisë ushqimore në rang vendi me disa produkte të rëndësishme si sheqeri, melasa apo niseshteja si dhe e industrisë së përpunimit të drurit, por falimentimi i kësaj industrie solli papunësi të lartë në qytet dhe largimin e një pjese të konsiderueshme të banorëve. Në zonat malore banorët i kanë dhënë prioritet blegtorisë dhe bletarisë ndërsa problematike mbetet prerja masive e pyjeve.

3.4.3 Përdorimi i tokës në zonën e projektit

Zona ku propozohet të ndërtohet termocentrali përfaqësohet nga toka të braktisura dhe toka bujqësore ku janë kultivuar bimë të ndryshme si: jonxhë, misër, grurë apo pemë frutore molla dhe kumbulla). Parcelat e tokave brenda zonës së propozuar për termocentralin me gaz, janë të rrethuara me kanale dreanzhimi dhe kullimi të populluara më së shumti nga: kallamishte të llojeve (*Typha latifolia*, *Phragmites australi*) dhe lulëkuqe (*Sparganium erectum*).

Gjurma e kalimit të tubacionit së gazsjellësit është i lokalizuar në anën e majtë të rrugës rurale dhe kalon më së shumti përmes tokave bujqësore të kultivuara me jonxhë, misër dhe grurë. Tubacioni i ri i gazsjellësit do kalojë paralel me kanalin e drenazhimit të zonës (e lokalizuar në anën e djathtë të rrugës rurale) i cili drenazhon ujin e trajtuar nga Impianti i Trajtimit Të Ujit të Ndotur të Korçës.

Linja e Transmetimit do kalojë përmes tokave bujqësore të fshatrave Malavec, Shamoll, Plasa dhe Zëmbllak. Këto toka bujqësore janë më së shumti të përfaqësuara nga toka të kultivuara me jonxhë, grurë, bimë mjeksore, misër dhe pemë frutore (molla dhe kumbulla). Parcelat e këtyre tokave janë të rrethuara me kanale drenazhimi dhe kullimi, të populluara më së shumti me lloje kallamishtesh dhe lulekuqe.

3.4.4 Administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura urbane

Në terma rajonalë, Komuna e Korçës menaxhon mbeturinat komunale me anë të dy stacioneve të transferimit dhe një deponi sanitare të vendosur në Maliq. Megjithatë, janë vëzhguar disa zona të ndotura me mbetje urbane dhe inerte, të cilat mendohet të jenë gjeneruar nga banorët vendas gjatë aktiviteteteve të përditshme të punës, aktiviteteteve bujqësore dhe aktiviteteteve të mëparshme të gjurmimit.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Gjithashtu, siç është përmendur, qyteti i Korçës ka në funksionim Impiantit e Trajtimit të Ujërave të Ndotura, i cili trajton ujërat e ndotura urbane të qytetit. Ky impiant, i cili ndodhet pranë vendndodhjes së do të jete dhe burimi kryesor për sigurimin e ujit teknologjik gjatë funksionimit të TEC-it.

4 Ndikimet negative në mjedis

4.1 Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit

Ndikimet më të mundshme në ujërat sipërfaqësorë gjatë fazës së ndërtimit parashikohen të jenë në kanalet ujëtore dhe kanalet kulluese të zonës, duke marra parasysh faktin që zona e propozuar për zhvillim është tokë bujqësore, ashtu dhe në lumin e Devollit ku drenohen ujrat e të gjithë kanaleve kulluese të zonës. Efektet e mundshme në ujërat sipërfaqësorë si pasojë e aktiviteteve të zbatimit të projektit mund të përfshijnë:

- Ndotja e mundshme nga automjetet/pajisjet si rezultat i derdhjes aksidentale të karburantit/vajit;
- Rritja e mundshme e turbullirës së ujit në trupave ujorë gjatë punimeve në afërsi të tij për shkak të shtimit të sedimenteve;

Në përgjithësi ndikimet në cilësinë e ujërave sipërfaqësorë priten të jenë të ulëta.

Për sa i përket fazës së funksionimit të termocentralit, vlen të theksohet se termocentrali nuk do të përdorë burime ujore sipërfaqësore për procesin e ftohjes. Efektet e mundshme në ujërat sipërfaqësorë për këtë fazë mund të përfshijnë:

- Cilësinë e ujit në rrjedhën ujore sipërfaqësore, i cili mund të ndikohet për shkak të shkarkimit të efluentit ose ujit të përdorur nga procesi i ftohjes.
- Aksidentet/ngjarjet e paplanifikuara: Ujërat sipërfaqësorë të zonës (ujërat e kanaleve të kullimit dhe ujitjes) mund të ndoten përmes derdhjeve aksidentale të karburanteve/vajrave.

Këto ndikime priten të jenë të mesëm, duke marrë parasysh faktin që receptorët kryesorë janë kanale ujëtore/ vaditëse me sensibilitet të papërfillshëm¹ si dhe në distancë vija lumore me sensibilitet të mesëm dhe të lartë.

Ndikimet e mundshme të ujërave nëntokësorë që mund të priten gjatë punimeve ndërtimore janë:

- Nivelet e ujërave nëntokësore mund të ndikohen nga procesi i nxjerrjes së ujit nëntokësor (ndërtimi i dy puseve për rastet e emergjencës) për shfrytëzim nga projekti;
- Kujdes duhet treguar në hapjen e themeleve apo sondave të nevojshme për punimet konstruktive për të shmangur kontaktet me ujërat nëntokësore;
- Ujërat nëntokësore mund të ndoten si pasojë e derdhjeve aksidentale të karburanteve apo ngjarjeve të paplanifikuara;

Impaktet e pritshme pa masa lehtësuese/ mbrojtëse priten të jetë deri mesatare.

¹ Në kategorinë kanale jo natyrorë që klasifikohen si receptorë me sensibilitet të papërfillshëm

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Nuk pritet të kemi ndikime të rëndësishme në ujërat nëntokësore gjatë fazës së funksionimit. Bazuar në karakteristikat e shtresave dhe nivelet e ujrave nëntokësorë në zonën e projektit kemi një zonë me sensibilitet të mesatarisht të ndjeshëm (akuifer i mbrojtur me shtresë argjilore); Impaktet e pritshme pa masa lehtësuese/ mbrojtëse pritet të jetë deri mesatare. Këto ndikime priten të jenë të ulëta, mbas marrjes së masave zbutëse.

Burimet kryesore të ndikimeve të mundshme në cilësinë e ajrit të mjedisit gjatë fazës së ndërtimit të projektit të propozuar janë:

- Gjenerimi i pluhurave për shkak të përgatitjes së zonës së kantierit, punimeve të gërmimit, dhe lëvizjes së makinerive dhe automjeteve;
- Emetime potenciale të gazrave SO₂, NO_x, Komponimet organike të paqëndrueshme (VOC) dhe grimcave PM₁₀ nga makineritë e ndërtimit dhe automjetet, si dhe nga gjeneratorët statikë që përdoren për prodhim energjie.

Aktivitetet e ndërtimit mund të rezultojnë në nivele të rritura të pluhurit, por ky ndikim do të jetë i përkohshëm dhe i kufizuar në nivel lokal. Duke patur në konsideratë largësinë e banesave nga zona e projektit, këto ndikime konsiderohen si të mesme.

Gjatë fazës së funksionimit, shkarkimet në ajër do të jenë kryesisht nga burime pikësore stacionare, burimet e lëvizshme dhe burimet fugjitive të emetimeve. Burimet e emetimeve fugjitive përfshijnë depozitat, valvolat, fllanxhat dhe lidhjet e tubave. Burimet e lëvizshme përfshijnë automjetet e përdorura për transportin e punëtorëve dhe të materialeve.

Gjatë fazës së ndërtimit do të përfshihen punime si pastrimi i vegjetacionit, rrethimi dhe nivelimi i vendit, si dhe punimet e gërmimit.

Efektet e mundshme në dherat si pasojë e ndërtimit të projektit mund të përfshijnë:

- Ndryshimin e karakteristikave të tokës në zonën e përcaktuar për ndërtim për shkak të punimeve të gërmimit;
- Cilësia dhe karakteristikat e tokës mund të ndryshojnë për shkak të ngjeshjes së krijuar gjatë aktivitetit ndërtimor;

Duke marrë në konsideratë sensibilitetin e tokës ku do të zhvillohet projekti² ndikimi në cilësinë e tokës gjatë fazës së ndërtimit konsiderohet si e mesme.

Përsa i përket fazës së funksionimit, nuk parashikohet të ketë ndikime të rëndësishme, për shkak të karakteristikave të tokës dhe nivelit të ndjeshmërisë së saj. Për këto arsye, ndikimi në cilësinë e tokës gjatë fazës funksionale konsiderohet si i ulët/i papërfillshme.

Në lidhje me emetimin e zhurmave dhe vibrimeve gjatë fazës ndërtimore, duhet theksuar se ky ndikim është i përkohshëm dhe lokal, vetëm në zonat e punës. Së pari faza e ndërtimit është një fazë e mirëpërcaktuar në kohë dhe së dyti aktivitetet e ndërtimit do të kryhen brenda orareve të zakonshme të punës. Më poshtë, paraqen kufijtë e lejuar të zhurmave, sipas direktivave europiane dhe legjislacionit shqiptar.

² Sensibilitet i mesëm, si toka me influencë antropogjenike që vazhdojnë të ruajnë funksionin natyrorë (si psh. Tokë përdoret për bujqësi

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Tabela 4-1. Standardet e nivelit të zhurmave në mjedis

Kategoria e zonës	Kufijtë e zhurmës	Dita (07:00 – 22:00)	Nata (22:00 – 07:00)
Zonë rezidenciale (e banuar)	dB (A)	55	45
Zonë industriale	dB (A)	70	70

Ndikimet nga zhurmat nuk do të jenë të ndjeshme gjatë procesit të ndërtimit për shkak të largësisë së impiantit nga vendbanimet. Përsa i përket vibrimeve, ato mund të gjenerohen nga makineritë e rënda gjatë punimeve, por duke qënë se nuk pritet të ketë punimë të rënda dhe zonat e punës janë larg banesave nuk priten ndikime.

4.2 Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit

Zona ku do ndërtohet TEC Korça, është tokë bujqësore dhe e pasur me mbulesë bimore (kultura bujqësore), pra kryesisht bimësi e ulët barishtore dhe të mbjella. Fakti që kufijtë e zonave të punës janë të mirëpërcaktuara sipas projektit ndihmon paraprakisht që ndikimi në zonat fqinje të jetë shumë i vogël.

Në fazën funksionale ndikimet në florë janë më pak të pritshme. Për shkak të teknologjisë së re të termocentralit dhe aplikimeve të kësaj teknologjie në projekte të ngjashme, pritet që emetimet në ajër të jenë brenda normave të lejuara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Përsa i përket faunës, këto ndikime nuk priten të jenë të rëndësishme duke marrë parasysh faktin se kemi të bëjmë me një zonë të prekur nga aktivitetet njerëzore dhe aktivitetet industriale. Punimet ndërtimore që mund të ndikojnë në shqetësimin e faunës paraqiten si në vijim:

- Heqja e bimësisë mund të rezultojë në ndikime të habitateve të kafsheve dhe zogjve.
- Zhurmat dhe vibrimet gjatë ndërtimit dhe funksionimit mund të shqetësojnë kafshët (botën e gjallë) dhe avifaunën (zogjtë).
- Rritja e lëvizjeve të automjeteve dhe makinerive gjatë ndërtimit mund të sjellë ndikime apo shqetësime të faunës.
- Përdorimi i pajisjeve ndiqëse gjatë fazës së ndërtimit mund të sjellë ndikime në faunën tokësore.

Ndikimet e mundshme në faunë gjatë fazës funksionale, si pasojë e gjenererimit të zhurmave gjatë aktiviteteve parashikohet të jenë minimale, thuajse zero. Zhurmat do të jenë të lokalizuara vetëm në zonën e projektit të termocentralit dhe parashikohen të jenë brenda niveleve të lejuara.

4.3 Ndikimet vizuale dhe ruajtja e peisazhit

Gjatë punimeve ndërtimore do të kemi ndikim në peizazh dhe në aspektin vizual për shkak të:

- Aktiviteteve të gërmimit, të cilat mund të ndryshojnë relievin e zonës në shkallë lokale;
- Pranisë së objekteve, pajisjeve dhe makinerive të termocentralit, të cilat mund të ndikojnë në aspektin vizual dhe peisazhor të zonës.

Punimet e gërmimit dhe ndërtimi i TEC-it do të shkaktojnë ndryshime të pjesshme të peizazhit ekzistues. Ndryshimet e pritura vizuale dhe peisazhore do të jenë më shumë të ndjeshme nga popullsia lokale.

				 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>	
Kompania	Abkons sh.p.k				
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)				

Gjatë fazës së funksionimit, ndikimi kryesor në peizazh/aspektin vizual do të jetë i shoqëruar me objektet e TEC-it së bashku me infrastrukturën e tij mbështetëse dhe linjën elektrike, të cilat do të mbeten, duke shkaktuar disa ndryshime të peizazhit ekzistues. Ndikimet në peizazh priten të zbuten më kalimin e kohës dhe nëpërmjet procesit të rehabilitimit dhe rimbjelljes së zonave të ndikuara nga proceset ndërtimore. Duke marrë në konsideratë masat zbutëse dhe karakteristikat natyrore të zonës, këto ndikime priten të jenë të ulëta.

4.4 Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve

Menaxhimi i ujërave të ndotur urbanë të gjeneruara nga punonjësit e termocentralit, gjatë fazës ndërtimore do të bëhet nëpërmjet mini-tualeteve portative, të cilat do të vendosen në zona të ndryshme, në varësi të shpërndarjes së punimeve.

Ujërat e ndotura të gjeneruara nga operimi i TEC Korçë mund të përfshijnë:

- ujërat e ndotura nga sistemi i trajtimit të ujit;
- ujërat e ndotura nga pompat e vajit të lëndës djegëse, të cilat mund të përmbajnë vaj;
- ujërat e ndotura shtëpiake nga kuzhina dhe kanalizimet.

Kërkesat për ujë (për kullat e ftohjes dhe sistemin e ftohjes së mbyllur, si dhe kërkesa për ujë për të gjitha proceset e tjera) gjatë ndërtimit dhe funksionimit të impiantit të propozuar do të sigurohen nga uji i trajtuar nga impianti i trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe përdorimi i ujërave nëntokësore si burim rezervë uji (vetëm në rast emergjence do të nxjerr ujë nga dy pusët në zonë). Kapaciteti i puseve do të jetë 20-30 l/s secili. Kapaciteti total i impiantit të ujërave të ndotura në 2016 ishte 4,407,813 m³ dhe një mesatare mujore prej 139 l/s.

Gjatë fazës së funksionimit, shkarkimet në ajër do të jenë kryesisht nga burime pikësore stacionare, burimet e lëvizshme dhe burimet fugjitive të emetimeve. Ndotësit kryesorë të lëshuar nga burime të tilla përfshijnë NO_x, SO₂, CO, PM₁₀, UHC dhe Komponimet organike të paqëndrueshme (VOCs).

Emetimet në ajër nga Termocentrali i Korçës do të jenë si më poshtë:

Tabela 4-2: Emetimet në ajër të TEC-it të Korçës

	Në 100% fuqi	Në 75% fuqi	Në 50% fuqi	Në 30% fuqi
	mg/Nm ³	mg/Nm ³	mg/Nm ³	mg/Nm ³
NO _x	50	50	50	50
CO	100	100	100	100

Të gjitha vlerat e mësipërme janë me 15% O₂ të thatë, në temperaturën 0 °C dhe 101.3 kPa.

Emetimet në ajër për impiantin e ujit të nxehtë (80 MW), me karburant gazin natyror, duhet të jenë:

Tabela 4-3: Emetimet në ajër të impiantit të ujit të nxehtë (80 MW), me karburant gazin natyror

Vlera kufi e shkarkimit	E Mesme	E Lartë
	mg/Nm ³	mg/Nm ³

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

NOx	200	100
CO	100	100
Të ngurta		

Të gjitha vlerat e mësipërme në janë me 3% O₂ të thatë, në temperaturën 0 °C dhe 101.3 kPa.

Emetimet në ajër për impiantin e ujit të nxehtë (80 MW), me karburant nafte extra të lehtë, duhet të jenë:

Tabela 4-4: Emetimet në ajër për impiantin e ujit të nxehtë (80 MW), me karburant nafte extra të lehtë

Vlera kufi e shkarkimit	E Mesme	E Lartë
	mg/Nm ³	mg/Nm ³
NOx	350	300
CO	1700	350
Të ngurta	150	20

Të gjitha vlerat e mësipërme në janë me 3% O₂ të thatë, në temperaturën 0 °C dhe 101.3 kPa

Gjatë fazës ndërtimore sasitë më të mëdha të mbetjeve të gjeneruara do të jenë dherat natyralë të tepërt nga procesi i gjurmimit, të cilat sipas preventivit përlllogariten rreth 90,000 m³. Në lidhje me llojet kryesore të mbetjeve urbane që mund të gjenerohen ato përfshijnë mbetjet organike ushqimore, mbetjet e zyrave (letër, karton, pastikë, etj), mbetje të ambalazheve të materialeve (plastike, letër, karton, etj), metale, mbetje druri, si dhe mbetje të llojeve të tjera. Mbetjet e rrezikshme të ngurta dhe të lëngshme do të përfshijnë, vajra dhe lubrifikantë, tretësit pastrues, mbeturinat e vajrave, llumet me vaj, bojërat, bateritë, konteinerët e materialeve të rrezikshme, tokat e kontaminuara nga derdhjet, etj.

Gjatë funksionimit, sasitë kryesore të mbetjeve të ngurta parashikohen që të jenë mbetjet e gjeneruara nga përdorimi i kimikateve në impiantin e demineralizimit (De-Mi water) dhe mbetjet e zyrës, duke përfshirë kartonin/letërën, qelqin, mbetjet ushqimore dhe kanaçet.

4.5 Ndikimet sociale të projektit

Aspektet socio-ekonomike të cilat mund të ndikohen janë:

➤ Shëndeti dhe Siguria e Komunitetit

- Emetimet e pluhurit dhe gazeve të makinerive / automjeteve të krijuara gjatë aktiviteteve të ndërtimit mund të ndikojnë në cilësinë e ajrit dhe për pasojë në shëndetin e komunitetit.
- Aksidentet / ngjarjet e paplanifikuara: Cilësia e ujit të shkarkimeve të efluentit dhe ngjarjet e paplanifikuara mund të ndikojnë në shëndetin e komunitetit.
- Lëvizja e materialeve dhe punëtorëve gjatë fazës së ndërtimit mund të ndikojë në sigurinë publike.
- Dëmtimet e paligjshme të tubacioneve të gazit mund të ndikojnë në sigurinë publike.

➤ Shëndeti dhe Siguria e Punonjësve

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Aktivitetet e rrezikshme në punë gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit mund të ndikojnë në Shëndetin dhe Sigurinë e punonjësve.
- Ruajtja dhe përdorimi i materialeve të rrezikshme mund të ndikojë në Shëndetin dhe Sigurinë e punonjësve.

➤ **Demografia e Komunitetit Lokal**

Marrja e tokës dhe procesi i gjurmëve mund të rezultojnë në zhvendosjen e komuniteteve të ndikuara lokale.

➤ **Struktura Sociale dhe Kulturore**

- Prania e punonjësve në zonën e projektit dhe paratë që ata fitojnë dhe shpenzojnë mund të shkaktojnë ndryshime në mënyrën e jetesës dhe zakonet e zonës lokale.
- Ndikimet në mënyrën e jetesës së zonës lokale (p.sh., bujqësia) nga aktivitetet e ndërtimit të projektit dhe funksionimit të tij, mund të rezultojnë gjithashtu në ndikime në institucionet sociale.

➤ **Përdorimi i Tokës dhe Kushtet e Jetesës**

- Aktivitetet e gjurmëve do të ndikojnë në bujqësinë e zonës.
- Transportimi i mbetjeve nga kantier dhe transporti i materialeve dhe pajisjeve nëpërmjet rrugëve lokale mund të rezultojë në ndikime të komunitetit lokal për sigurimin e të mirave jetësore të tyre.
- Marrja e tokës dhe procesi i gjurmëve mund të rezultojnë në shqetësim dhe/apo humbje të të mirave jetësore.

➤ **Ekonomia Lokale dhe Makroekonomia**

- Prania e punonjësve të ndërtimit në zonën e projektit mund të sjellë rritje të ekonomisë lokale përmes blerjeve të të mirave në nivel lokal.

➤ **Infrastruktura dhe Shërbimet**

- Prania e punonjësve në zonën e projektit mund të sjellë ndikim në infrastrukturën dhe shërbimet sociale lokale (ujë, energji elektrike, rrugë, shkolla, qendra shëndetësore, etj.).

➤ **Trafiku dhe Transporti**

- Punimet e gjurmëve mund të rezultojnë në ndikime në rrugët lokale të transportit, shtigjet e këmbësorëve dhe rrugët e aksesit në tokat e zonës.
- Transporti i pajisjeve dhe makinerive (p.sh., turbinat me gaz, tubacionet e gazit, etj.) gjatë fazës së ndërtimit mund të ndikojë në transportin lokal dhe rrugët e aksesit.
- Prania e punonjësve gjatë fazës së ndërtimit dhe fazës së funksionimit në zonë mund të rezultojë në ndikime në trafikun e rrugëve lokale të transportit.

➤ **Trashëgimia Kulturore**

- Punimet e gjurmëve dhe aktivitetet e tjera ndërtimore mund të sjellin ndikime në zonat lokale kulturore apo arkeologjike (zonat e pazbuluara, veçanërisht zonat nëntokësore të cilat mund të rezultojnë në zbulimin e objekteve arkeologjike)

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

5 Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis

5.1 Metodatat e zbatuara për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis

5.1.1 Vlerësimi i Ndikimeve dhe Metodologjia

Faza e vlerësimit të ndikimit, e cila bazohet në rezultatet e studimit të kushteve ekzistuese mjedisore dhe sociale për TEC Korçë, vlerëson rëndësinë e ndikimeve të mundshme të identifikuar, përfshirë efektet kumulative dhe identifikon masat zbutëse që mund të minimizojnë/zvogëlojnë ose kompenzojnë ndikimet negative dhe/apo të rrisë përfitimet. Gjetjet biofizike dhe socio-ekonomike të përfshira në raportin e VNM-së së thelluar, i cili është dokumenti kryesor në të cilin bazohen vendimet mjedisore në lidhje me projektin. Hapat e përfshirë në fazën e vlerësimit të ndikimit përshkruhen më në detaje në paragrafin më poshtë.

Vlerësimi i ndikimit në mjedis që përdoret për projektin e propozuar përfshin një qasje që kombinon **Magnitudën e Ndikimit dhe Ndjeshmërinë e Receptorit** për të përcaktuar **Rëndësinë e Ndikimit. Metodologjia** që përdoret për të identifikuar dhe vlerësuar ndikimet e mundshme të Projektit të Propozuar paraqitet në figurën më poshtë.

Figura 5.1 Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimeve në Mjedis



Burimi: ERM 2003

5.2 Shtrirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuar (shkalla)

5.2.1 Shtrirja e mundshme hapësinore e ndikimeve negative në mjedis

Ndikimet e mundshme në mjedisin e zonës janë vlerësuar në mënyrë të veçantë për secilin prej aspekteve mjedisore dhe sociale. Zona e mundshme për ndikim është përcaktuar nëpërmjet Zonave të Influencës të cilat potencialisht mund të ndikohen nga aktivitetet e projektit. Të dhënat për këto zona influence paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 5.1 Zonat e Influencës për secilin prej aspekteve mjedisore dhe sociale

Elementi/Aspekti Mjedisor	Zona e Influencës
Ajër	Deri në 5 km rreze nga zona e propozuar për ndërtimin e termocentralit (përfshirë tubacionin e gazit). Zona e influencës për linjën e transmetimit është përcaktuar brenda një korridorit të gjerë prej 0.5 km (0.25 km në secilën anë të linjës së transmetimit).

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Elementi/Aspekti Mjedisor	Zona e Influencës
Tokë	Deri në një rreze prej 40m përreth zonës së ndërtimit dhe deri në 1 km rreze nga termocentralit për funksionimin (përfshirë tubacionin e gazit). Zona e influencës për linjën e transmetimit është përcaktuar brenda një korridorit të gjerë prej 0.5 km (0.25 km në secilën anë të linjës së transmetimit).
Burime ujore sipërfaqësore, përfshirë lumenjtë, përrrenjtë, rrjedhat ujore, kanalet e kullimit dhe kanalet e drenazhimit.	Rrezja e impaktit (për cilësinë e ujrave) do të jetë nga disa qindra metra deri në 1 km të rrjedhjes së poshtme nga pika e intersektuar e kanalit; (zona për ndërtimin dhe funksionimin e termocentralit si dhe duke përfshirë tubacionin e gazit). Zona e influencës për linjën e transmetimit është përcaktuar brenda një korridorit të gjerë prej 0.5 km (0.25 km në secilën anë të linjës së transmetimit).
Burimet ujore nëntokësore brenda zonës hidrologjike të influencës.	Deri në 1 km rreze nga zona e propozuar për ndërtimin e termocentralit (përfshirë tubacionin e gazit). Zona e influencës për linjën e transmetimit është përcaktuar brenda një korridorit të gjerë prej 0.5 km (0.25 km në secilën anë të linjës së transmetimit).
Zhurmat dhe ndriçimi	Nga disa metra deri në 2 km rreze nga zona e propozuar për ndërtimin e termocentralit (përfshirë tubacionin e gazit). Zona e influencës për linjën e transmetimit është përcaktuar brenda një korridorit të gjerë prej 0.5 km (0.25 km në secilën anë të linjës së transmetimit).
Flora dhe Fauna, (përfshirë avifaunën dhe ekologjinë ujore)	Deri në 2 km rreze nga zona e propozuar për ndërtimin e termocentralit (përfshirë tubacionin e gazit). Zona e influencës për linjën e transmetimit është përcaktuar brenda një korridorit të gjerë prej 0.5 km (0.25 km në secilën anë të linjës së transmetimit).
Trashëgimia Kulturore	Zona e ndërtimit të projektit dhe objektet e lidhura me projektin.
Aspekti social-ekonomik	Deri në 2 km rreze nga zona e propozuar për ndërtimin e termocentralit (përfshirë tubacionin e gazit). Zona e influencës për linjën e transmetimit është përcaktuar brenda një korridorit të gjerë prej 1 km (0.5 km në secilën anë të linjës së transmetimit).

		 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k	
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)	

5.2.2 Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve negative të identifikuara

Tabela 5.2. Kohëzgjatja e mundshme e ndikimeve negative të identifikuara

Aspektet/Receptorët	Ndikimet e mundshme	Aktiviteti/Çështja	Kohëzgjatja	
			Faza Ndërtimore	Faza Funktionale
<i>Cilësia e Ajrit</i>	Emetime të puhurave	Aktivitetet e gërmimit dhe punimet ndërtimore.	✓	
	Emetime të gazeve	Aktivitetet ndërtimore, lëvizjet e automjeteve dhe trafiku, si dhe operimi i termocentralit.	✓	✓
<i>Toka</i>	Ndotja e tokës	Ndotje potenciale e tokës për shkak të aktiviteteve të punës.	✓	
	Depozitimi i dherave natyralë	Mund të ketë nevojë për vend-depozitime të përkohshme gjatë aktivitetit ndërtimor.	✓	
<i>Uji</i>	Kanalet e kullimit/ ujitjes	Ndryshime në skemën e kanaleve të ujitjes dhe kullimit në zonë.	✓	✓
	Ndikime në ujërat nëntokësorë	Shpimi dhe funksionimi i dy puseve të cilat do të përdoren nga termocentrali në rast emergjencash.	✓	✓
	Ndikime në ujërat sipërfaqësorë	Shkarkimi i efluentëve në kanalën kryesor kullues të zonës.		✓
<i>Biodiversiteti</i>	Ndikime në florë	Pastrimi i sipërfaqeve dhe procesi i gërmimit.	✓	
	Ndikime në faunë	Punimet e gërmimit. Operimi i termocentralit. Nuk priten ndikime gjatë fazës së funksionimit.	✓	✓
	Ndikime në zonat e mbrojtura	Nuk janë evidentuar zona të mbrojtura apo monumente natyrore.		
<i>Peizazhi</i>	Ndryshimi i peizazhit	Do të kemi humbje të florës dhe tokës bujqësore.	✓	
	Ndikimi vizual	Mund të sjellin ndikime në aspektin vizual.	✓	✓
<i>Popullata/komuniteti</i>	Ndikimet socio-ekonomike	Priten ndikime positive në ekonominë lokale, gjatë dy fazave.	✓	✓
	Emetimet në ajër	Emetime pritet të jenë brenda niveleve të lejuara.	✓	✓
	Zhurmat dhe vibrimet	Faza e ndërtimit dhe funksionimit mund të rezultojë në rritje të nivelit të zhurmave dhe vibrimeve në zonë.	✓	✓
	Trafiku dhe lëvizja e automjeteve	Aktivitetet e TEC-it mund të shkaktojnë trafik në rrugët lokale të zonës, dhe problematika të ndryshme në aspektin e sigurisë	✓	✓



LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards

Kompania	Abkons sh.p.k
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)

Aspektet/ Receptorët	Ndikimet e mundshme	Aktiviteti/Çështja	Kohëzgjatja	
			Faza Ndërtimore	Faza Funktionale
		rrugore dhe aspektin mjedisor.		
Trashëgimia Kulturore	Ndikimet në trashëgimninë kulturore	Gjatë fazës së studimit nuk janë evidentuar monumente arkeologjike.	✓	

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

6 Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit(nëse ka të tilla)

Ndikimet kryesore të projektit të propozuar parashikohen në cilësinë e ajrit. Projekti i termocentralit të Korçës do të shfrytëzojë si lëndë djegëse një nga lëndët fosile me më pak ndikim në mjedis, siç është ai i gazit. Bazuar në standardet dhe udhëzimet e IFC-së, Konsulenti ka parashikuar se ndikimet e mundshme në mjedis mund të shtrihen brenda një zonë influence me rreze deri ne 5 km nga impianti i termocentralit. Projekti i propozuar nuk parashikohet të ndikojë në mjedisin ndërkufitar, sepse emetimet e tij do të shkarkohen brenda territorit të shtetit Shqiptar dhe nuk do të ndikojë në shtetet fqinje.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

7 Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

7.1 Masat zbutëse për ndikimet në ujërat sipërfaqësore

- Investitori duhet të marrë parasysh kërkesat e komunitetit, për përdorimin e ujit të trajtuar në impiantin e ujërave të ndotura, i cili aktualisht përdoret për vaditje të tokave në zonë;
- Të parandalohet bllokimi i kanaleve ujitëse/vaditëse dhe sigurohet mirëmbajtja e tyre gjatë fazës së punimeve;
- Të sigurohet mirëmbajtja e makinerive/pajisjeve, në mënyrë që të zvogëlohet rreziku i derdhjes së karburantit/vajit;
- Të kryhet menaxhimi i duhur i materiale dhe mbeturinave;
- Mbledhja e ndarë e mbeturinave sipas llojeve të përcaktuara në ligjin Nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar;
- Kufizimi i furnizimit me karburant/mirëmbajtjes së makinerisë/pajisjeve në vendet e ndërtimit. Nëse ka nevojë urgjente, duhet të bëhet të paktën 100 metra larg trupave ujqorë, kjo për efekt të zbatimit të masave të caktuara të sigurisë për parandalimin e derdhjeve (dhe rrjedhimisht parandalimin e ndotjes së tokës dhe ujit);
- Në rast të derdhjes së karburantit/vajit në tokë, duhet të kryhet lokalizimi i materialit të derdhur dhe pastrimi i menjëhershëm i zonës së ndotur në mënyrë që të parandalohet hyrja e ndotësve në ujë;
- Ndalohet larja e makinerive/automjeteve apo edhe larja e betoniereve pranë trupave ujqorë;
- Ndalohet shkarkimi i ujërave të ndotura urbanë drejtpërdrejt në trupat ujqorë pa trajtim paraprak;
- Trajnimi i rregullt i stafit të kantierit për çështjet e mjedisit dhe sigurisë.

7.2 Masat zbutëse për ndikimet në ujërat nëntokësore

- Monitorimi i vazhdueshëm i sasisë së ujit në dy pusët ku do merret uji nëntokësor;
- Monitorim periodik i cilësisë së ujit nëntokësor sipas kërkesave të ligjit;
- Kontrolli i vazhdueshëm dhe mirëmbajtja e makinerive dhe automjeteve për parandalimin e rrjedhjeve/derdhjeve të karburantit;
- Në rast të një derdhje apo rrjedhje karburanti/vaji/kimikati në tokë ose në trup ujqor duhet të kryhet menjëherë ndërhyrja dhe pastrimi i zonës së ndikuar;
- Menaxhimi i mirë i mbetjeve të ngurta dhe të lëngshme në kantier;
- Trajnimi i punonjësve për mbrojtjen e ujërave nëntokësore nga ndotja.

7.3 Masat zbutëse për ndikimet në cilësinë e ajrit

- Zvogëlimi i nivelit të pluhurit nga burimet e trajtimit/përpunimit të materialeve, duke përdorur mbulesa;

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Gjatë procesit të ndërtimit duhet të lagen sipas nevojës rrugët e aksesit dhe zonat e punës, me frekuencë 1-2 herë në ditë për zvogëlimin e emetimeve të pluhurave, veçanërisht në territore të populluara apo në afërsi të banesave;
- Punimet e gërmimit, si heqja e dheut vegjetal dhe materialit të tepërt, depozitimi i grumbujve të dherave të gërmuar, duhet të planifikohen duke marrë në konsideratë kushtet meteorologjike (p.sh, temperatura, drejtimi i erës dhe shpejtësia) dhe vendodhjen e pritësve të ndjeshëm;
- Aktivitetet e gërmimit duhet të kryhen në kushte të njoma (me ujë), në mënyrë që të zvogëlohen emetimet e pluhurave;
- Rrugët e aksesit brenda zonës së projektit duhet të mirëmbahen periodikisht në mënyrën e duhur nga kontraktori;
- Për lëvizjen e materialeve në kantier duhet të përdoren konteinerë të mbyllur;
- Të respektohet shpejtësia maksimale e lëvizjes së automjeteve dhe makinerive në zonën e kantierit 20 km/orë, e cila ndihmon edhe në zvogëlimin e emetimeve të pluhurit.
- Përdorimi nga personeli i Veshjeve Mbrojtëse Individuale (maskat, respiratorët) në zonat me gjenerim të lartë pluhuri;
- Eskavatorët, fadromat, dozerat dhe makineritë e tjera duhet të jenë të pajisura me ajër të kondicionuar, filtra ajri, etj;
- Turbina e gazit do të jetë e pajisur me impiant për reduktimin e ndjeshëm të emetimeve të NOx;
- Automjetet duhet të inspektohen dhe t’u bëhen rregullisht shërbimet e automjeteve për të garantuar një performancë optimale që zvogëlon krijimin e emetimeve në ajër;
- Monitorimi i rregullt i cilësisë së ajrit në zonë gjatë fazës së funksionimit të termocentralit.

7.4 Masat zbutëse për ndikimet në cilësinë e tokës

- Heqja e shtresës së sipërme tokës (dheut vegjetal) dhe depozitimi i tij në zona të përkohshme, në mënyrë që mos të ndikohet cilësia e tij;
- Mbrojtje e rreptë e kufijve të zonës së punës sipas projektit për të shmangur ndotje, e mundshme tek zonat "fqinjje", dëmtimin e shtresave pjellore të tokës apo shkatërrimin e saj;
- Sigurimi i funksionalitetit të rregullt të pajisjeve dhe makinerive, me qëllim parandalimin e ndotjes së tokës nga derdhen e karburantit/vajit;
- Grumbullimi i mbeturinave sipas llojit të përcaktuara në ligjin Nr. 10463 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” i ndryshuar dhe ruajtja e përkohshme e tyre në zona të veçanta të paracaktuara;
- Kufizimi i larjes së makinerive apo pajisjeve të ndotura me karburant/vaj në tokë;
- Në rast të derdhjes së karburantit/vajrave, duhet të kryhet lokalizimi i materialit të derdhur dhe pastrimi i menjëhershëm i zonës së ndotur;
- Kontroll i vazhdueshëm në zonat e ruajtjes së materialeve të rrezikshme dhe mbetjeve për të parandaluar derdhjet apo ndotjet e mundshme;
- Trajnimi i stafit për çështjet e mjedisit dhe sigurisë, përpara fillimit të punës dhe gjatë zhvillimit të saj;
- Pastrimi i territorit dhe rehabilitimi pas përfundimit të punimeve ndërtimore.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknikë e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

7.5 Masat zbutëse për kontrollin e zhurmave dhe vibrimeve

- Kontroll i rregullt i funksionalitetit teknik të automjeteve, makinerive dhe pajisjeve që do përdoren gjatë ndërtimit dhe gjatë fazës së funksionimit;
- Të gjitha automjetet dhe pajisjet duhet të pajtohen në çdo kohë me standardet dhe rregullat përkatëse Shqiptare për emetimet.
- Shmangja e operacioneve gjatë natës dhe përdorimi i zbutjeve specifike mbi pajisjet e zhurmshme (mbështjellë akustike).
- Përdorimi i panelave anti-zhurmë rrethues në zona ku tejkalohe kufiri i lejuar;
- Lajmërim i banorëve lokale për punimet ndërtimore (në rastet kur punimet kryhen në afërsi të zonave të banuara);
- Sigurimi i personelit me mjete mbrojtëse individuale (mbrojtëse për veshët);
- Instruktimi i stafit para fillimit të punimeve dhe gjatë punimeve.

7.6 Masat zbutëse për ndikimet nga mbetjet dhe dherat natyralë të gjermuar

Qëllimi kryesor i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme është:

- Zvogëlimi i volumit të mbetjeve të gjeneruara;
- Identifikimi dhe ndarja e tyre sipas llojit;
- Ruajtja në vende të posaçme të përcaktuara;
- Përdorimi ose trajtimi;
- Transferimi / transportimi;
- Ripërdorimi dhe riciklimi;
- Depozitimi final.

Ndërkohë, dherat natyrorë të gjermuar, do të menaxhohen sipas prioriteteve të mëposhtme. Drejtuesi i projektit (kantierit) duhet të koordinojë dhe të menaxhojë lëvizjet apo depozitimet e dherave.

1) **Prioriteti i parë:** Ripërdorimi në kuadër të projektit;

Aty ku dherat e gjermuar janë të përshtatshëm dhe mund të përdoren gjatë punimeve, atëherë kjo duhet të konsiderohet ripërdorim për qëllime projekti, p.sh, mbushje apo ndërtim i veprave mbrojtëse kundër erozionit, etj.

2) **Prioriteti i dytë:** Ripërdorimi nga një palë e tretë;

Transferimi tek një palë e tretë për qëllime ripërdorimi, si p.sh, përdorimi i dheut vegjetal për rehabilitimin e tokave në afërsi, etj.

3) **Prioriteti i tretë:** Vend-depozitimi;

Masa e dherave të tepërt të gjermuar dhe mbetjeve inerteve (p.sh, betone ekzituese) të gjeneruara gjatë fazës ndërtimore duhet të depozitohet në vend-depozitime të përcaktuara në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës.

Ndër masat kryesore zbutëse që mund të përmenden për menaxhimin e dherave natyralë të gjermuar dhe mbetjeve urbanë dhe të rrezikshme janë:

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

- Materialet e tepërt të gjeneruar (dhera natyralë) - gjatë proceseve të gjermimit të veprave të ndryshme duhet të përdoren sa më shumë të jetë e mundur brenda kuadrit të projektit (p.sh, mbushje, mbrojtje e trupave ujqorë, rehabilitim tokash, etj); pjesa e mbetur e dherave duhet të depozitohet në zonat e në bashkëpunim me Bashkinë e Korçës;
- Vend-depozitimet e materialeve inerte - Duhet të ruhet gjithmonë një distancë minimale prej 100 m nga trupat ujqorë. Sugjerohet ngjeshja e tarracave dhe sheshit kryesor për të krijuar një bazament të fortë dhe kompakt;
- Mbetjet urbane - duhet të menaxhohen në kosha të ndarë sipas llojit të mbetjeve p.sh., letër/karton, qelq/plastikë, mbetje organike dhe mbetje të rrezikshme. Evadimi i mbetjeve urbane duhet të kryhet në bashkëpunim me institucionet lokale (si Bashkia e Korçës), të cilat do të përcaktojnë vendet e depozitimit të mbetjeve (apo landfillet) ku Kontraktori duhet të depozitojë këto mbetje. Një zgjidhje alternative është edhe kontraktimi i një kompanie të licensuar për evadimin e mbetjeve dhe riciklimin e tyre;
- Mbetjet e rrezikshme - mbetjet e rrezikshme që potencialisht mund të gjenerohen gjatë aktivitetit ndërtimor duhet të grumbullohen në kosha të veçantë të shënuar me emertimin “Mbetje të rrezikshme” dhe evadimi i tyre duhet të kryhet me anë të kontraktorëve të pajisur me liçencë III.2.B sipas kërkesës së VKM nr. 371, datë 11.06.2014 “Për miratimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”;
- Sasitë e gjeneruara të mbetjeve urbane dhe mbetjeve të rrezikshme - duhet të regjistrohen në një regjistër të veçantë sipas llojit të mbetjeve dhe sasive mujore të gjeneruara. Gjatë procesit të evadimit të mbetjeve duhet të plotësohet një formular (Formati i Transferimit të Mbetjeve) për transferimin dhe dorëzimin e mbetjeve ku të përcaktohen sasitë përkatëse sipas llojit të mbetjeve që largohen nga kantieri dhe emri i kompanisë/subjektit që merr në dorëzim këto mbetje. Këto të dhëna duhet të ruhen në mënyrë të rregullt nga Kontraktori gjatë aktivitetit ndërtimor dhe nga Investitori gjatë fazës funksionale të termocentralit;
- Ujërat e ndotura urbanë – Të gjithë efluentët dhe sasitë e ujërave të ndotura urbane do të ndahen dhe do të dërgohen për trajtim në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotur të termocentralit gjatë fazës së funksionimit dhe më pas do të shkarkohen në kanalën ujëtare. Ndërsa gjatë fazës së ndërtimit do të përdoren banjot kimike portative, për punonjësit e kantierit. Ujërat e ndotura urbane nuk do të shkarkohen pa trajtim paraprak. Gjatë fazës ndërtimore do të menaxhohen në zonat e punës me anë të vendosjes së mini-tualeteve, aty ku konsiderohet e nevojshme. Evadimi i ujërave të ndotur urbanë do të kryhet me anë të kontraktorëve të licensuar për këtë lloj shërbimi, të cilët do të kontrahohen nga Kontraktori dhe Investitori gjatë fazës së ndërtimit;
- Zonat e ruajtjes së mbetjeve, materialeve të rrezikshme dhe kimikateve duhet të jenë të përcaktuara paraprakisht dhe të jenë të ndërtuara sipas kushteve të duhura mbrojtëse për të eliminuar çdo ndotje të mundshme të tokës apo ujërave. Shoqërimi i këtyre zonave duhet të bëhet me vendosjen e sinjalistikës përkatëse për evidentimin e llojit të mbetjeve dhe rrethim më rrjetë të kuqe të zonës;
- Duhet të kryhen trajnime të vazhdueshme për stafin e kantierit për menaxhimin e mbetjeve në terren.
- Të gjitha mbetjet e lëngshme duhet të pajtohen me standardet dhe rregulloret në Shqipëri për cilësinë, temperaturën dhe aromën përpara se të shkarkohen në mjedis, përfshirë Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 177, datë 31 Mars 2005 “Mbi Normat e Shkarkimit të Ujërave të Ndotur”.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

7.7 Masat zbutëse për ndikimet në florë

- Mbrojtje strikte e kufijëve të zonave të ndërtimit, në mënyrë që të zvogëlohen risqet e dëmtimit të mbulesës bimore; në mënyrë të veçantë duhet të mbrohen kufijtë e zonave ku do kalojë linja elektrike dhe ku do vendosen shtyllat, pasi sipërfaqja që zënë dhe gjatësia e linjës është e konsiderueshme;
- Përfshirja e një biologu/inxhinieri pyjesh/inxhinier mjedisi si pjesë e stafit gjatë fazës ndërtimore, në mënyrë që të monitorohet rregullisht procesi i prerjeve të bimësisë dhe respektimi i rregullave të sistemit të menaxhimit mjedisor;
- Të trajnohet stafi i kantierit për mbrojtjen e bimësisë para fillimit të punës dhe gjatë saj;
- Në rast të identifikimit të specieve të mbrojtura, ato duhet të trajtohen në përputhshmëri me legjislacionin Shqiptar për “Listën e kuqe të specieve të Mbrojtura”;
- Prerjet e sipërfaqeve të bimësisë dhe numri i pemëve duhet të regjistrohen dhe të raportohen në institucionet përkatëse në rast se kërkohen;
- Të kryhet rimbjellja e zonave të ndikuara gjatë rehabilitimit me dhe vegjetal.

7.8 Masat zbutëse për ndikimet në faunë

- Mbrojtje e kufijve të zonave të ndërtimit sipas përcaktimeve në projekt;
- Respektimi i kufijve të shpejtësisë në kantier për të zvogëluar mundësinë e ndikimit të drejtpërdrejtë (aksident);
- Zbatimi i masave zbutëse për zvogëlimin e pluhurit gjatë zbatimit të punimeve;
- Prerja e pemëve nuk duhet të kryhet gjatë periudhës së shumimit të zogjve, periudha Prill-Korrik;
- Menaxhimi i duhur i mbeturinave dhe shmangia sa më shumë të jetë e mundur e shkarkimeve të ndryshme apo edhe shkarkimeve që mund të ndodhin në mënyrë aksidentale;
- Marrja e masave për të kufizuar rrjedhjet e produkteve të naftës/vajit dhe substancave të tjera të rrezikshme në trupat ujorë dhe tokë;
- Trajnimi i stafit para fillimit të punimeve dhe gjatë fazës ndërtimore për mbrojtjen e faunës.

7.9 Masat zbutëse për ndikimet vizuale dhe ruajtjen e peizazhit

- Zbutja e ndikimeve vizuale nëpërmjet zgjedhjes së duhur të ngjyrave dhe projektimit të ndërtesave;
- Ruajtja e strukturave të përkoshme, materialeve dhe mbeturinat në mënyrë të tillë që të jenë më pak të dukshme nga pikëpamja vizuale;
- Zbatimi i Planit të Rehabilitimit të përcaktuar në raportin e VNM-së;
- Nivelimi i sipërfaqeve dhe përshtatja me relievin e zonës;
- Mbrojtja e zonave të rrezikuara nga erozioni;
- Rigjëlberimi i sipërfaqeve të ndikuara nga punimet, duke vlerësuar densitetin e fidanëve, larminë e llojeve dhe mbulesën bimore, siç është parashikuar në planin e miratuar të rehabilitimit;
- Rehabilitimi dhe rigjëlberimi i vend-depozitimeve të projektit;

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

7.10 Masat zbutëse për sigurinë në punë

Për të parandaluar rrëziqet dhe për të mundësuar zbatimin korrekt të rregullave të sigurisë, është e rëndësishme mbikqyrja e vazhdueshme e punimeve. Zbatimi i rregullave të sigurisë nënkupton:

- Udhëzim dhe trajnim të personelit për çështjet e shëndetit dhe sigurisë para fillimit të punës dhe gjatë zhvillimit të punës;
- Personeli që punon në lartësi duhet të sigurohet me litarë të posaçëm dhe pajisje të tjera mbrojtëse;
- Paralajmërimin e duhur nëpërmjet vendosjes së tabelave në zonat e punës për personelin dhe popullsinë lokale;
- Përdorimi nga personeli i Veshjeve Mbrojtëse Individuale (kaskë, doreza, këpucë, syze, jelek, etj.);
- Ndalimi i hyrjes për personat e paautorizuar në kantier;
- Zbatimi maksimal i rregullave të sigurisë në punë gjatë ekzekutimit të operacioneve të transportit;
- Në fazën e ndërtimit dhe në fazën e funksionimit, Kompania është e detyruar të caktojë punonjës të shëndetit dhe sigurisë. Ata duhet të kontrollojnë nivelin e pajtueshmërisë me kërkesat e sigurisë dhe të mbajnë një regjistër të veçantë për regjistrimin e çështjeve ku janë shkelur normat e sigurisë.

Shëndeti dhe siguria në punë e punëtorëve sanitarë do të sigurohet, veçanërisht nëpërmjet sigurimit të pajisjeve të sigurta dhe faciliteteve të përmirësuara në termocentral. Kryesisht do të mbahen në monitorin, mbrojtja nga zjarri ku do të kemi:

- Sistem me sprinklera shkumë-ujë të montuar në ambiente të ndryshme të termocentralit që shërbejnë për të realizuar fikjen e menjëhershme të zjarreve të vogla të mundshme. Sistemi duhet të jetë automatik si dhe manual;
- Monitorë me ujë dhe shkumë për të mbajtur nën kontroll dhe fikur flakët e mëdha që mund të vijnë si pasojë e aksidenteve apo flakëve të dala jasht kontrollit;
- Në ambientet e shërbimit do të vendosen fikse zjarri portative si dhe buton i sinjalizimit të zjarrit me veprim manual;
- Vendosja e sistemit të detektimit të prezencës së gazit natyror të përdorur si lëndë e parë në termocentral, e lidhur me sistemin e sinjalizimit zanorë dhe pamor për prezencë gazi në ambient si pasojë e ndonjë rrjedhje të mundshme;
- Parashikimi i rrugëve të aksesit për mjetet zjarrfikëse.

7.11 Mekanizmi i Ankesave

GPP Korça do të krijojë një mekanizëm ankimi për të qenë në dijeni të problematikave dhe për t'iu përgjigjur shqetësimeve të palëve të interesit, si dhe për të lehtësuar zgjidhjet për ankesat e mundshme nga palët e interesit. Mekanizmi i ankesave do t'i adresojë shqetësimet menjëherë dhe në mënyrë efektive, duke praktikuar një proces të kuptueshëm dhe transparent, i cili është i përshtatshëm në aspektin kulturor dhe lehtësisht në ndihmë për të gjithë segmentet e palëve të ndikuara, pa kosto dhe pa masa administrative.

			 <i>LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards</i>
Kompania	Abkons sh.p.k		
Titulli i dokumentit	Përmbledhje Jo Teknike e Raportit të Thelluar të VNM-së – Termocentrali me Gaz në Korçë (GPP Korça)		

Praktikat më të mira ndërkombëtare përshkruajnë kërkesat e nevojshem për mekanizmat e ankesave. Mekanizmat e ankesave duhet të marrin dhe lehtësojnë zgjidhjen e shqetësimeve dhe ankesave të komuniteteve të ndikuara. Ky proces përfshin një mekanizëm të pavarur dhe objektiv, i cili nuk do të pengojë qasjen në mjetet juridike apo administrative.

Procesi i marrjes së ankesave përfshin hapat e mëposhtëm:

- Identifikimin;
- Regjistrimin dhe kategorizimin;
- Njohjen e së Drejtës së personit ankimues;
- Hetimin / investigimin dhe përgjigjen;
- Komunikimin e përgjigjes dhe kërkesës për reagimet mbi çështjen nga ana e palëve të interesuara; dhe,
- Mbylljen e procesit.

Për të siguruar që mekanizmi i ankesave është aktiv dhe gjithëpërfshirës, palët e interesuara kanë disa metoda komunikimi në dispozicion të tyre për të raportuar një ankesë.

Këtu përfshihen ankesat:

- **Verbale:** Palët e interesuara mund të kontaktojnë Zyrën e GPP Korça në numrin e mëposhtëm 067 520 6606. Ankesat verbale u drejtohen përfaqësuesve të GPP Korçës, të cilët do të plotësojnë formularin e ankesave me të gjitha detajet e kërkuara dhe do t'ia kalojnë atë Menaxherit të Angazhimit me Palët e Interesuara në zyrën qendrore; dhe,
- **Me shkrim:** Palët e interesuara mund të dorëzojnë ankesën e tyre duke plotësuar një formular ankesë që do të jetë në dispozicion në zyrën qendrore ose më lehtësisht, ata mund të dorëzojnë shqetësimin e tyre me email në adresën qa@gppkorca.com ose me shkrim në adresën e mëposhtme:

GPP KORÇA

Adresa: Lagjja Nr. 1, Pogradec, Shqipëri

Email: qa@gppkorca.com

Telefon: 067 520 6606

Në këtë mënyrë, është e rëndësishme të sigurohet që këto ankesa të pranohen, të hetohen dhe brenda një kohe të shkurtër të zgjidhen dhe më pas të jenë në gjendje të zgjidhen të gjithë ankesat e hapura për komunitetin. Ankesat mund të jenë një tregues i shqetësimeve në rritje të palëve të interesuara (reale dhe të perceptuara) dhe mund të përshkallëzohen nëse nuk identifikohen dhe nuk zgjidhen. Menaxhimi i ankesave është një komponent vital i menaxhimit të palëve të interesuara dhe një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit të rrezikut për një projekt.